



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 24 QERSHOR 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 24. JUNA 2019. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2019**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me rastin e dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq më 29 mars 2018

Dnevni red

1. Razmatranje Izveštaja Istražne parlamentarne komisije u vezi proterivanja šest (6) turskih državljanina, dana 29 marta 2018

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 48 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovë.

Ne do të procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018

Të nderuar deputetë,

48 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin e raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars.

Komisioni Hetimor Parlamentar në mbështetje të nenit 23 të Ligjit 03/L-176 për hetim parlamentar e ka dorëzuar raportin përfundimtar.

Unë ju njoftoj që këtë seancë do ta drejtoj në bazë të autorizimit të kryetarit të Kuvendit.

E ftoj kryesuesin e Komisionit Hetimor Parlamentar, zoti Xhelal Sveçla, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin e komisionit.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më 29 mars të vitit 2018 dy agjencitë kryesore për siguri në vend, me urdhrin e eprorit të tyre bënë shkeljen më të madhe të sovranitetit të vendit tonë nga vetë ata që duhet ta mbrojnë, AKI dhe Policia e Kosovës.

Duke shkelur me dy këmbët Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, por edhe konventat ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, ata arrestuar gjashtë shtetas turq me qëndrim të ligjshëm dhe i dorëzuan në duar të një shërbimi të jashtëm, domethënë jashtëligjshëm i ekstraduan ata.

Tre muaj pas ngjarjes Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të neneve 65.1 dhe 77.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 71 të Rregullores së Kuvendit si dhe neni 4.3 të Ligjit numër 03/L-176 për hetim parlamentar.

Në seancën plenare të mbajtur më 23 qershor 2018, bazuar në kërkesën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur edhe nga deputetët e tjerë, me Vendimin nr. 06/V-170, datë 28.6.2018, themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018.

Komisioni, në përputhje me dispozitat e Ligjit numër 03/L-176 për hetim parlamentar, ka hartuar planin e veprimit të Komisionit Hetimor Parlamentar si dhe buxhetin e Komisionit Hetimor Parlamentar të miratuara më 10 korrik 2018, respektivisht 15 tetor 2018.

E gjithë puna e komisionit ka kaluar në katër faza.

Faza e parë, konsolidimi i komisionit, gjatë të cilës kohë është përgatitur plani i veprimit dhe buxheti, nga i cili vetëm një pjesë e vogël është shpenzuar.

Mbledhja e dëshmimeve nga institucionet dhe organizata të ndryshme.

Intervistimi i zyrtarëve dhe dëshmitarëve si dhe vlerësimi i hetimeve dhe përpilimi i raportit.

Qëllimi i Komisionit Hetimor për gjatë gjithë punës së saj ka qenë zbulimi i të vërtetës së çka ka ndodhur në këtë rast, identifikimi i lëshimeve dhe shkeljeve ligjore, identifikimi i mangësive ligjore, si dhe procedimi i shkeljeve të identifikuara për institucionet relevante.

Në fazë të planit të veprimit Komisioni ka kërkuar një sërë dokumentesh prova materiale nga institucionet e përfshira në rastin objekt hetimi, shumica nga të cilat janë vënë në dispozicion, për këtë gjë unë i falënderoj.

Megjithatë, më duhet ta theksoj dështimin e AKI-së, Policisë së Kosovës dhe Presidencës që t'u paraqiten kërkesave të komisionit për dorëzimin e provave shtesë, përkundër që komisioni ka qenë në dijeni për ekzistencën e këtyre provave. Si për shembull, CD e incizimeve dhe fotografitë e realizuara nga kamerat e Aeroportit të Prishtinës që pasqyrojnë mënyrën e realizimit të depërtimit, e të cilat Policia i ka marrë nga autoritet e aeroportit, por të njëjta nuk ia ka dorëzuar komisionit.

Pas analizimit të provave të pranuar, komisioni brenda mandatit të tij ka intervistuar dëshmitarët në përputhje me listën e aprovuar në plan të veprimit.

27 dëshmitarë janë ftuar në intervistim dhe dy prej tyre dhe në riintervistim, për shkak të diskrepancave në deklaratat e tyre.

Këtu vlen të përmendet mosgatishmëria e presidentit që t'u përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Në paraqitjen e tij pas katër thirrjeve të dështuara më herët, presidenti Thaçi ka refuzuar të dëshmojë para komisionit, duke bërë kërkesa të paligjshme dhe akuza të paqena ndaj komisionit dhe ekspertit të pavarur të angazhuar nga komisioni.

I gjithë opinioni është dëshmitarë se si ai me sjelljen e tij plotësisht të papërgjegjshme u mundua të minojë dhe të devalvojë punën e komisionit, gjë që qartazi dështoi.

Për të përcaktuar rolin e tij konkret në dëbimin e gjashtë shtetasve turq, por edhe rolit të tij destruktiv ndaj punës së komisionit, përfshirë edhe deklaratimeve të rrejshme nën betim, i mbetet Prokurorisë Speciale, e cila po e heton rastin.

Në përputhje me mandatin, komisioni përfundoi punën më 15 maj 2019. Meqenëse raporti i komisionit i është dorëzuar Kryesisë së Kuvendit më 24 maj, Kryesia e Kuvendit sipas Ligjit për hetim parlamentar numër 06/L-176, neni 23.5, ka qenë e obliguar që brenda 30 ditësh të njëjtin ta dërgojë në seancë plenare për shqyrtim.

Duke parë që Kryesia nuk ka vullnet ta bëjë këtë, ne jemi detyruar të thërrasim këtë seancë të jashtëzakonshme, do të thotë, përputhjet plotësisht, një muaj pas dorëzimit të raportit në Kryesinë e Kuvendit.

Për sa i përket strukturës së raportit të komisionit përveç hyrjes, pra pjesës një, pjesa dy paraqet një përmbledhje gjithëpërfshirëse të fakteve relevante lidhur me dëbimin e gjashtë shtetasve turq.

Së dyti, në bazë të fakteve, pjesa tre paraqet një vlerësim juridik lidhur me rastin, kurse pjesa katër paraqet vlerësimin juridik, një listë me përmbledhje të të gjitha shkeljeve, parregullsive dhe mospërputhjeve me Kushtetutën, ligje, akte nënligjore, procedura, standarde dhe instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që komisioni ka gjetur në rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq.

Dhe, së fundit, për shkak se disa prej këtyre shkeljeve kanë rezultuar të paktën pjesërisht prej mangësive në ligje në fuqi në Republikën e Kosovës.

Pjesa e pestë ofron disa rekomandime specifike për Kuvendin, duke marrë parasysh në veçanti kompetencat ligjvënëse të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Edhe gjatë procesit të marrjes së vendimeve për revokimin e leje qëndrimeve të shtetasve turq, por edhe gjatë vetë operacionit për dëbimin e gjashtë shtetasve turq, konstatohet një varg i gjatë i

shkeljeve, parregullsive dhe mospërputhjeve me ligje dhe akte nënligjore në fuqi si dhe me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në raportin të cilin ne e kemi dorëzuar, kemi identifikuar 31 shkelje, të cilat nuk do t'i lexoj në këtë rast, por të cilat janë të njohura si për deputetët, po ashtu edhe për publikun si dhe, siç e përmenda më herët, edhe një listë rekomandimesh për Kuvendin e Kosovës.

Por, po ashtu duhet theksuar se në kuadër të këtyre shkeljeve, vendimet për revokim të leje qëndrimit dhe urdhrat për largim me forcë janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, e këtë e konfirmojnë edhe vendimet gjyqësore të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, e cila ka anuluar këto vendime:

Vendimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme për revokimi të leje qëndrimit të Mustafa Erdem, Gjihan Oskan, Hasan Hysejn Demir dhe Jusuf Karabina.

Po ashtu Gjykata Themelore fillimisht ka anuluar edhe vendimin për revokimin e leje qëndrimit të Kahraman Demirel, mirëpo për shkak të gabimeve teknike procedurale lënda është kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit.

Të njëjtën kohë Gjykata Themelore po ashtu ka anuluar vendimet për urdhër largim me forcë për Mustafa Erdem, Kahraman Demirel, Osaman Karakaja si dhe për Gjihan Oskan, vendimi i të cilit ka kaluar në shkallën e dytë.

Në fund, si kryetar i komisionit, më duhet t'i falënderoj të gjithë ata, të cilët në një mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi ndihmuan apo mbështetën komisionin në punën e tij që të hetojë ngjarjen dhe pastaj të përgatisë këtë raport, me të cilën në mundësinë e tij maksimale për rrethanat zbulon të vërtetën për këtë rast.

Ky raport në komision u miratua jo vetëm me votat e opozitës, por edhe me votat e deputetëve të pozitës që kanë qenë të gatshëm për të bashkëpunuar.

Prandaj, ju ftoj që ta votojmë këtë raport, i cili sipas shumicës së atyre të cilët kanë pasur rastin ta lexojnë, për nga kualiteti dhe gjithëpërfshirja e fakteve të cilat dëshmojnë se çfarë ka ndodhur me rastin e dëbimit të paligjshëm të gjashtë shtetasve turq, vendos standarde të reja në punën e komisioneve hulumtuese parlamentare jo vetëm për Kuvendin e Kosovës, por edhe më gjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i LDK-së, deputeti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, nënkryetar Shala!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, normalisht që ndjehemi mirë që, më në fund arritëm që këtë dokument ose këtë raport ta sjellim para jush, përkundër një vonese të jashtëzakonshme, sepse nëse mbani mend, ne në muajin maj, LDK-ja bashkë me Vetëvendosjen, e kemi pas nisur iniciativën për ta themeluar këtë komision dhe tash, sot jemi më shumë se një vit ka kaluar, por e rëndësishme është që dokumenti është para nesh, pavarësisht qasjeve destruktive edhe brenda komisionit, por nganjëherë edhe duke ndihmuar edhe Kryesia e Kuvendit edhe Administrata e Kuvendit me gjykime dhe interpretime prej më absurdeve për Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Tash para kemi një dokument, i cili paraqet në detaje se çfarë ka ndodhur me rastin e depërtimit të gjashtë shtetasve turq dhe cila ka qenë, them situata në të cilën ne jemi ballafaquar.

E para, ka qenë me disa dëshmitarë që nuk kanë dashur të vijnë të raportojnë, por kanë ditur shumë dhe, nga ana tjetër, kemi pasur disa dëshmitarë që kanë ardhur, siç ka qenë kryeministri i Kosovës, e që, në fakt, ka thënë që 's'kam ditë asgjë', e përgjigjja është e thjeshtë: të gjithë e kanë ditur, po normalisht dikush më pak e dikush më shumë, për të gjithë bartësit e institucioneve në Kosovë informatat i kanë pasur që një proces i tillë do të ndodhë.

Ajo çka është e rëndësishme është që kjo çështje ose ky rast është rasti më eklatant për ta kuptuar se si autoriteti shtetëror është në gjendje të shkelë çdo normë, çdo dispozitë ligjore, kushtetuese, të cilat i obligojnë për t'u sjellë ata, e që në fakt, janë të gatshëm që t'i shkelin ato.

Cilat janë disa nga përfundimet që ne i kemi nxjerrë aty?

E para është suprimimi i institucioneve të tjera.

Çka i bie kjo? Janë lënë anash të gjitha institucionet, të cilat kanë mandat për t'u marrë me këtë çështje.

Nuk është njoftuar Prokuroria e Shtetit për rrezikun që këta persona, nëse eventualisht i kanosen Kosovës, nuk janë njoftuar gjykatat e Kosovës, nuk janë njoftuar departamentet ose nuk janë përfshirë departamentet e rëndësishme brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kryer obligimin e tyre dhe çka është bërë? Është bërë me çështje telefonatash, me çështje bisedash dhe të gjitha institucionet kompetente shtetërore në Kosovë pothuajse janë marginalizuar dhe janë vënë në shërbim të një misioni, e si duket adresën e ka të saktë, por do ta them pak më vonë.

Pse e them këtë, sepse një viti para se të ndodhë kjo ngjarje, njëri nga prokurorët e Kosovës ka thënë që prej shtetit të Turqisë ne kemi pasur kërkesë për ekstradim për dy shtetas të depërtuar. Por cila ka qenë përgjigja e prokurorisë? Ka qenë që ne aq që duhet t'i trajtojmë këto raste, sepse e dimë që në vendin, të cilin këta mund të ekstradohen mund t'i nënshtrohen torturës.

Dhe, kur prokurori i shtetit e jep këtë vlerësim, del një institucion, superinstitucion që është AKI-ja, Shërbimi Sekret i Kosovës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe thotë 'në këtë vend nuk ka gjykata, këtë vend s'ka prokurori, por ne vendosim se kush rrezikon sigurinë nacionale dhe ne vendosim se kujt ia vendosim thesin në kokë dhe e përzëmë nga Kosova'.

Çështja e dytë ka të bëjë me atë të tejkalimit të kompetencave mes institucioneve. Ku është intenca këtu? Policia e Kosovës ka hequr dorë prej mandatit të saj për të kryer operacion policor.

Ka pasur operacionin policor në mandat me ligjin që të ecë tutje për çdo çështje që rrezikohet siguria nacionale në Kosovë.

Nga ana tjetër, AKI-ja ka marrë autorizime policore, ka tejkaluar mandatin e vet kushtetues që e ka.

Në zyrat e Policisë së Kosovës kanë hyrë agjentë të AKI-së dhe e kanë menaxhuar operacionin policor.

Policia në terren nuk kanë komunikuar me përgjegjësit e tyre, me shefat e tyre, kanë komunikuar me dy agjentë të AKI-së, atyre u kanë dhënë llogari, me ata janë konsultuar dhe kjo, në fakt, tregon që siguria individuale dhe nacionale në Kosovë është në pikëpyetje, sepse AKI-ja është në gjendje të suprimojë krejt institucionet e tjera, po normalisht dikush tjetër qëndron përmbi AKI-në, për të cilin do ta them pak më vonë. Që i bie se e gjithë kjo kemi të bëjmë një subordinim, domethënë institucioni më kryesor i Sigurisë së Kosovës, që është Policia e Kosovës, i subordinohet në totalin e vet AKI-së, e që, në fakt, kjo nuk guxon të ndodhë, sepse mandati i AKI-së është marrja e informatave dhe dhënia e informatave tek institucionet kompetente, gjithçka përfundon aty. Po këtu ka ndodhur krejtësisht tjetra. Ka ndodhur që mandatin ekzekutiv ta marrin ata.

Çka kemi bërë në rastin tjetër, i cili në fakt shpreh shqetësimin më themelor. Shteti me vetëdije kryen vepër penale, shteti i Kosovës, dhe cila është ajo?

Në momentin kur e kupton që një person po depërtohet gabimisht, e ka kuptuar, sepse na e kanë thënë vetë komandantët e Policisë së Kosovës, thotë në aeroport e kemi marrë informatën që një person është gabimisht dhe cila ka qenë përgjigjja e tij?

Kemi kontaktuar persona të AKI-së dhe ata kanë thënë: 'Përzini edhe këtë, se letrat i ndreqim mandej'.

Që i bie shteti me vetëdije të plotë u vendos thesin në kokë personave krejtësisht të gabuar dhe i depërton, pavarësisht se ai ka pasur leje qëndrim të përhershëm në Kosovë dhe ka pasur leje

pune në Kosovë dhe kjo normalisht që paraqet vepër penale, dënim deri në tetë vjet burgim, ku shteti me vetëdijen e plotë realizon një qëllim.

Rasti tjetër, kemi pasur rastin e Mustafa Erden, ka qenë një person, i cili ka aplikuar në Kosovë me shtetësinë e Shqipërisë dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë e thonë që nëse një person ka dy shtetësi, me shtetësinë me të cilin ai ka aplikuar në Kosovë, ne duhet ta depërtojmë, ishte dashur me rregulla që ne ta depërtojmë në Shqipëri, po jo atje ku e kemi dërguar.

Pse e thashë përpos presidentit, përpos shefit të Policisë, shefit të AKI-së, informata ka pasur edhe kryeministri. Sepse ka kaluar një vit që kompania turke që ka aplikuar për leje në Kosovë për aterrim, e ka keqpërdorur lejen, ka aplikuar për leje për operim biznesi, ndërkohë ka ardhur për qëllime krejtësisht të tjera dhe asnjë veprim nga ana e Ministrisë së Transportit nuk është marrë, përkundër që Ligji për aviacionin civil e thotë qartazi që mund ta gjobisim deri në një milion euro. Asnjë veprim i vetëm dhe heshtja e këtyre institucioneve tregon që të gjithë e kanë ditur, të gjithë i kanë pasur informatat, por disa shiten që nuk dinë, disa shiten që nuk kanë interes as nuk flasin për këtë çështje.

Çështja tjetër që për mendimin tonë paraqet shqetësim është dallimi ose gënjeshtria në dëshmi para komisioni. Dy bartësit e institucioneve kryesore të sigurisë në Kosovës, shefi i AKI-së dhe shefi i Policisë, deklarata kontradiktore krejtësisht të kundërta me njëra-tjetrën.

Ish-shefi i Policisë, zoti Shpend Maxhuni, na ka dëshmuar, ka thënë që unë këtë informatë për deportim e kam kuptuar pasi kanë shkuar ata në Turqi, ndërkohë shefi i AKI-së thotë së paku tri ditë përpara ai e ka pasur informatën e tillë.

Atëherë, nëse personat e sigurisë në Kosovë janë të gatshëm që nën betim të japin deklaramë të rrejshme, të dëshmojnë rrejshëm, çfarë janë në gjendje t'i bëjnë shtetit të Kosovës ata, e për fatin e keq, ai shef i Policisë që neve na ka gënjyer, është avancuar. Ai është avancuar dhe ka shkuar shef i AKI-së, e ish-shefi i AKI-së, për të cilin ne po themi që ka dhënë të dhëna kontradiktore, u rehatua në zyrën e Presidentit. Atëherë, për çfarë gjendje të situatës së sigurisë jemi duke folur në Kosovë, nuk është çështja veç e deportimit, është çështja e sigurisë tonë, e secilit prej deputetëve dhe secilit njeri që jeton në Kosovë. Rasti i fundit që e vërteton këtë, rasti i Moldavisë, më 11 qershor Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut merr vendim për rastin pothuajse të njëjtë në Kosovë që ka ndodhur, për deportimin e gjashtë shtetasve turq dhe shpall fajtorin shtetin e Moldavisë, rast krejtësisht i ngjashëm. Po të lexohet me kujdes aktgjykimi, e shihni, rast tërësisht të ngjashëm, përpos që te ne kanë qenë gjashtë, te ata pesë. Dhe Gjykata Evropiane ka ardhur në përfundim që janë shkelur këto nene dhe e kanë shpallur shtetin e Moldavisë fajtor.

Po, kush është urdhërdhënësi i krejt kësaj?

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne të gjithë e dimë, populli i Kosovës e di dhe s'kemi qare pa e thënë këtë. Ne si komision s'kemi arritur normalisht të marrim dëshminë e askujt për të thënë që, po, urdhrin e kemi marrë prej Presidentit Thaçi. Po ne e dimë që zyra e tij, ai është urdhërdhënësi i krejt këtij procesi. Pse e them këtë? Mosgatishmëria e tij për të ardhur në komision dhe, e dyta, kur ka ardhur qasja e tij tallëse ndaj komisionit, janë disa nga dëshmitë që tregon që ai person është mbrapa kësaj. Fyerja që i bëri ekspertit të angazhuar nga ne, e që është një ekspert me renome, Tjen Muma, madje na tha kështu: "Informatat e tilla të ndjeshme ai person i ka dërguar te shtetet jomike të Kosovës dhe këtë informatë tha e kam marrë nga institucionet e sigurisë në Kosovë". Dhe kur ne e pyetëm shefin e AKI-së a i keni dërguar informata Presidentit të Kosovës për këtë person, tha "As që ka kërkuar ndonjëherë". Dhe, ne as që i kemi, pas deklaratave të Presidentit, që i bie nga kush informohet Presidenti i Kosovës. A mos informohet prej Branislav Nikoliqit që e ka atë këshilltarin e tij të BIA-s serbe brenda kabinetit të tij.

Të nderuar kolegë deputetë, ky problem nuk është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Një minutë, jo më shumë.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, krejt në fund, normalisht që fakti pse Presidenti Thaçi është fajtor, ne i dimë edhe falënderimet që i vinin prej Presidentit të Turqisë, falënderimet publike, duke e falënderuar vëllain e tij, megjithatë ne i bëjmë thirrje Prokurorisë së Shtetit që personat e tillë të involvuar në këtë proces, që i bie prej Presidentit deri te polici më i thjeshtë që ka marrë pjesë në këtë operacion, të jenë prapa grilave dhe të mos jenë në krye të institucioneve ose në postet që ata i mbajnë sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, deputeti Hajdar Beqa. Urdhëroni!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot konsideroj që e kemi një pikë të rëndësishme, pavarësisht se ndoshta është dashur të ketë një seancë të rregullt, edhe ashtu komisioni u vonua për ta kryer punën e vet.

Ne si komision dhe si Parti Demokratike parapakisht e kemi dhënë qëndrimin tonë sa i përket rastit në fjalë edhe përmes kryetarit zotit Veseli, respektivisht në ditën kur ka ndodhur dëbimi i shtetasve të Republikës së Turqisë dhe kemi qenë dhe jemi të interesuar se kjo çështje të zbardhet nga organet kompetente sa më shpejt dhe të kemi një opinion të qartë, por jo në këtë rast të marrim poenë politike në fatkeqësinë që u ka ndodhur familjarëve të shtetasve turq. Ne si

komision, fatkeqësisht si anëtarë të komisionit gjatë punës tonë, edhe pse e kemi pasur një vullnet për të zbardhur çështjen gjatë të gjitha atyre dëgjimeve që i kemi dëgjuar në komision i kemi politizuar për interesa personale dhe ligjin e kemi kuptuar apo e kemi interpretuar në formë selektive. Për shembull, kemi pasur raste kur një ligj i caktuar, neni 1 thotë ndryshe, neni 2, ne i kemi referuar vetëm një neni. Unë duhet të them vetëm disa kundërshtime të mia që kam dashur t'i them edhe në komision, në mbledhjen e fundit, por e dimë që kanë votuar për pesë minuta anëtarët me shumicë të thjeshtë, dhe nuk kanë marrë qëndrimet edhe kundër kësaj. Gjatë rrugës unë konsideroj që e kemi prishur kredibilitetin e komisionit dhe kredibilitetin e punës së raportit. Unë do t'i them edhe faktet si i kemi prishur, sepse ne në momentin kur na ka përfunduar mandati, kemi dalë në emër të komisionit apo në emër personal dhe me prova, të cilat i kam pasur, të cilat kanë qenë mandati ynë ka qenë që raportin ta hartojmë dhe t'ia dorëzojmë Kryesisë dhe seancës së Kuvendit, e jo ta dorëzojmë në prokurori dhe në gjykata, që konsideroj kemi bërë një shkelje dhe një interferim në organet e drejtësisë.

Unë mendoj që detyrë jona ka qenë ta bëjmë një raport sa më të saktë dhe t'i gjejmë me të vërtetë shkeljet eventuale nëse kanë ndodhur, që t'i ndihmojmë organet e drejtësisë dhe jo t'i bëjmë konfuz organet e drejtësisë, por unë jam shumë optimist që ky raport më shumë e dëmton imazhin e punës së komisionit, se sa e rrit imazhin e institucioneve. Komisioni, së paku në tri raste ka dështuar të procedojë sipas nenit 12, paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit nr. 3L-176 për hetim parlamentar. Gjegjësisht, ka mbajtur mbledhje në mungesë të kuorumit, ndërsa në rastet e tilla kur gjatë mbledhjes konstatohet mungesa e kuorumit, kryesuesi është dashur të ndërpresë mbledhjen, si rrjedhojë kryesuesi i komisionit ka dështuar në zbatimin e procedurave dhe ligjshmërisë së komisionit, së paku në tri raste thashë janë marrë në intervistë dëshmitarët pa kuorum. Intervistat pa kuorum zhvlerësojnë provën si të tillë dhe nuk mund të përdoren në raportin përfundimtar, siç përcaktohet me nenin 18.3 të Ligjit nr. 3L-176 për hetim parlamentar.

E thashë edhe më herët, në këtë rast komisioni në disa raste ka vepruar në kundërshtim me nenin 16, publiciteti i mbledhjeve të komisionit të Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar dhe nuk kanë zbatuar në mënyrën e duhur çështjen e seancave të mbyllura të administrimit të provave dhe të ruajtjes së sekretit zyrtar. Publikimi i informatave dhe ecurisë së punës së komisionit, në këtë rast nga kryesuesi dhe anëtarët e komisionit është bërë në kundërshtim me nenin 11, pika 4 e nenit 18, pika 2, dhe nenit 23 pika 7 e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar. Raporti përmban detaje të shumta mbi burimet e provave dhe kjo paraqet edhe një shkelje të Ligjit për hetim parlamentar, ngase në nenin 23, pika 2 të këtij ligji është përcaktuar që detajet mbi burimet e provave nuk publikohen në raportin përfundimtar. Ne kemi raste që në raport jemi lëshuar shumë në detaje dhe detajet sipas ligjit e bëjnë raportin për, mendim tim, joprofesional, sepse nuk është etike që të lëshohet në detaje.

Unë do të ndalem vetëm në disa pika, për shembull: përfundimi i pikës 1, Ministria e Punëve të Brendshme, saktësisht Departamenti për shtetësi, azil dhe mërgim ka detyrim ligjor që në kuptim

të kërkesës së Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, AKI-së, e cila është edhe organ kompetent për sigurinë nacionale. Në mbështetje të neni 6, të Ligjit 04/L-219 për të huajt, që është edhe Gazeta zyrtare nr. 35/5 shtator 2013. Të veprojë bazuar në kërkesën në fjalë kur një i huaj cilësohet se paraqet rrezik për siguri kombëtare, sepse në të kundërtën, mosveprimi në bazë të kërkesës në fjalë do të përbente shkelje të ligjit dhe për pasojë, kryen disa vepra penale të parapara në Kodin Penal, i cili është në fuqi. Unë nuk do të lëshohem në të gjitha pikat, për arsye që kemi pasur disa kundërshtime dhe gjatë punës së komisionit. Jemi shumë të interesuar që kjo çështje të zbardhet, do të ndalem edhe të përfundimet nga pikat 4 dhe 5, pjesëmarrja në operacionin e AKI-së, u tha këtu nga anëtarët e komisionit apo mungesa e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe Policisë së Kosovës e bën të paqëndrueshme ligjërisht konkluzionin se kjo paraqet shkelje të të drejtave të njeriut apo tejkalim të mandatit kur komisioni nuk kishte asnjë deklaram, provë apo dëshmi që sugjeronte se zyrtarët e AKI-së kanë përdorur autorizime policore, sipas Ligjit të Policisë së Kosovës apo Kodit Penal, apo edhe Kodit të Procedurës Penale.

Përfundimet nga pikat 6 dhe 8 e raportit janë në kundërshtim me dokumentet e dorëzuara nga komisioni, e që janë në procedurë gjyqësore. Referencë, unë e them vetëm kështu, referencë e kam marrë është Vendimi i Gjykatës së Apelit, nr. Protokollit 15/69 i datës 21.02.2019, i cili ka gjetur shkelje të shumta ligjore në Vendimin e Gjykatës Themelore dhe ne e kemi marrë vetëm pjesën e Gjykatës Themelore dhe nuk iu kemi referuar çka thotë Gjykata e Apelit, si komision. Përfundimet në pikën 21, nuk është përgjegjësi e zyrtarëve të shqyrtojnë nëse ligji është në përputhje me konventën, përgjegjësi e tyre është zbatimi i ligjit themelor, e që në këtë rast është të Ligji për të huajt, neni 100, paragrafi 2 i Ligjit për të huajt e lejon kthimin e të huajve që paraqesin rrezik për sigurinë nacionale edhe në rrethana të jashtëzakonshme, edhe kjo pranohet edhe nga eksperti, i cili në faqen 55 të draft raportit deklaroi: “Neni 100, paragrafi 2 i Ligjit për të huajt, i cili e lejon dëbimin në rrethana të tilla, është i papajtueshëm me të drejtën ndërkombëtare, zakonore dhe me instrumentet ndërkombëtare përkatëse për të drejtat e njeriut”.

Në këtë rast, ne nuk mund të themi nëse ligji është në kundërshtim me konventën, nuk mund të themi që zyrtarët e kanë shkelur ligjin, por duhet të ndryshojmë ligjin, sepse zyrtarët në këtë rast do ta kishin shkelur ligjin sikur të mos e kishin respektuar nenin 100 të Ligjit për të huajt. Të ndalem edhe të neni, në këtë rast të pika 30, referimi, thashë edhe në fillim, kemi pasur referim selektiv të dispozitave të legjislacionit ndërkombëtar. Është i shpeshtë në këtë raport referimi selektiv, por referimi selektiv dhe interpretimi i njëanshëm e bën raportin të paqartë. Shembull e kemi rastin në pikën 30, edhe pse palët janë njoftuar me vendim, mirëpo eksperti ka theksuar protokollin nr. 7, neni 1, paragrafi 1 të Konventës, duke harruar që ky nen ka edhe paragrafin 2, që u jep të drejta autoriteteve të vepronë, ndërsa realisht institucionet e Republikës së Kosovës në këtë rast kanë vepruar në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi që përfshin edhe nenin 1.2 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Unë kisha thënë që komisioni nëse e kishte kryer punën sipas mandatit që e ka pasur nga kjo seancë dhe nuk ua kishim dorëzuar këtë raport, që sot ne po e shqyrtojmë, e diku para 3 muajve e ka secila media, secili portal, qytetar, prokuror apo avokat, unë mendoj që ky raport nuk e ka atë fuqinë që është dashur ta ketë dhe nuk do t'i ndihmojë drejtësisë, përkundrazi e bën më të paqartë në këtë rast, i bën më të paqartë organet e drejtësisë për të marrë një vendim të drejtë.

Unë nga kjo seancë bëj thirrje që prokuroria dhe gjykata sa më shpejt të bëjnë zbardhjen e këtij rasti dhe të mos bazohet shumë në raportin tonë. Nuk është shumë relevante a e votojmë ne sot këtë raport apo jo, por unë e them që e pamë edhe nga zoti Selmanaj kur thotë këtu zoti Thaçi ka dhënë urdhër. Në asnjë rast nuk kemi pasur që zoti Thaçi apo një zyrtar i lartë ka dhënë urdhër, por kemi këso dëbimesh me qindra gjatë vitit, kurse në këtë rast ne mendoj, nuk po them që është bërë mirë forma e dëbimit, por ne e kemi interes si vend dhe si institucionet ta zbardhim këtë rast, por jo ta politizojmë apo për interesa të partive politike t'i bëjmë publike provat.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sot, me siguri që do të flitet më shumë për ngjarjen dhe se si ka rrjedhur ajo, domethënë do të përpiqemi që edhe në detajet më teknike ta argumentojmë se çka ka ndodhur dhe t'i gjejmë t'i prezantojnë shkeljet e ligjit që kanë ndodhur. Mirëpo unë mendoj që ndoshta me rëndësi është të preket po ashtu dhe dëmi dhe ta shpjegojmë dëmin që është bërë përmes kësaj ngjarjeje që ka ndodhur në Republikën e Kosovës.

Unë dua të filloj prej dëmit të parë që është sjellja e një modeli krejt të papranueshëm të relacionit mes shtetit tonë dhe një shteti tjetër. Marrëdhëniet mes shtetit tonë dhe çdo shteti tjetër duhet të ndërtohen mbi parimet e reciprocitetit të partneritetit strategjik, të interesave të përbashkëta dhe të përfitimeve të dyanshme. Kurse, nëse e shohim këtë rast se si ka ndodhur, atëherë mund të konkludojmë që pushtetarët tanë kanë vendosur një relacion, unë do të thosha, të vasalitetit mes Kosovës edhe një pushteti politik të një shteti tjetër. Kjo nuk duhet të ndodhë dhe kjo e dëmton Kosovën shumë. Pra, nëse shihet se si ka ardhur urdhri dhe kërkesa prej pushtetit të Turqisë dhe qysh është zbatuar ajo kryekëput nga institucionet tona, kjo tregon që shteti i Kosovës, i prezantuar prej këtyre institucioneve, po zhvillon marrëdhënie vasaliteti, në fakt, me shtetin e Turqisë, nuk do duhej të ishte kështu. Ne duhet të zhvillojmë marrëdhënie mbi barazinë, reciprocitetin dhe interesat e përbashkëta, jo kështu qysh ka ndodhur.

E dyta, është bërë një dëm i jashtëzakonshëm sa u përket institucioneve të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tjera evropiane në dy dimensione: dimensionin e parë është procesi i integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, respektimi i të drejtave të njeriut nga shteti i Kosovës është crucial sa i përket ecjes tonë në drejtim të procesit të integritetit evropian.

Kur të bëhen raportet prej institucioneve relevante evropiane për neve, siç ndodhi në Raportin e Progresit, ju e patë që edhe Komisioni Evropian e kishte listuar këtë ngjarje si një të dështimeve më të mëdha të shtetit të Kosovës, mënyrën e dëbimit këtyre gjashtë shtetasve turq. Tjetra është që, siç e dini ju, me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prej instrumenteve dhe konventave ndërkombëtare të rëndësishme, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës, është edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, pra e cila ndodhet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kur është miratuar Kushtetuta e Kosovës pjesë integrale e Kushtetutës së Kosovës është edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Kjo Konventë është shkelur me të dyja këmbët në këtë rast, pra është shkelur edhe një dimension shumë i rëndësishëm ndërkombëtar, edhe vendor kushtetues, me këtë akt që ka ndodhur në Republikën e Kosovës.

Përmes kësaj është dëmtuar seriozisht procesi ynë për të aplikuar në Këshillin e Evropës, sepse të drejtat e njeriut dhe respektimi i të drejtave të njeriut është elementar për ecjen tonë përpara dhe për aplikimin tonë në Këshillin e Evropës. A, aplikimi në Këshillin e Evropës, e keni ju si prioritet në strategjinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës. Në strategji shkruan që njëri prej fokuseve të jashtme të Kosovës është aplikimi dhe anëtarësimi në Këshillin e Evropës: a e dini çka keni bërë ju me këtë ngjarje sa i përket perspektivës së aplikimit të Kosovës në këto institucione të rëndësishme ndërkombëtare?

Siç e dini ju në Këshillin e Evropës goditja e parë Kosovës i është bërë përmes raportit të Dik Martit, kjo ka pasur ardhur si goditje prej Serbisë, ama tash goditjen e dytë ne po ia bëjmë vetvetes, ia kemi bërë vetvetes goditjen e dytë, këtë goditjen përmes këtij deportimi skandaloz dhe të paligjshëm të gjashtë shtetasve turq. Tash, të dalim pak edhe te dimensionin e brendshëm, çka do të thotë në kuptimin e brendshëm kjo ngjarje.

Kjo e ka prekur drejtpërdrejt funksionimin ligjor të shtetit të Kosovës, nivelin e demokracisë në Kosovë, relacionin që e kanë institucionet mes njëra-tjetrës. Ky rast i deportimit tregon se prej Presidencës e deri te AKI-ja, policia dhe gjyqësori, përmes segmenteve të kontrolluara aty brenda janë të përfshira në këto shkelje të rënda. Qysh datën e nesërme kur pati ndodhur ky depërtim, nëse po ju kujtohet, kemi pasur tri deklarata të tre zyrtarëve të lartë të shtetit, njëra prej Presidentit Thaçi, tjetra prej kryeparlamentarit Veseli dhe e fundit prej kryeministrit Haradinaj. Presidenti Thaçi doli në konferencë për shtyp dhe tha që nuk ka shkelje. Kryeparlamentari Veseli tha që ka shkelje dhe duhet dikush të japë përgjegjësi, kurse kryeministri Haradinaj tha nuk po di kurrëgjë. Këto kanë qenë tri deklaratat zyrtare të përfaqësuesve më të lartë të shtetit tonë. Prej zhvillimeve të menjëhershme që ndodhën në ditët në vijim, menjëherë pasi kjo ngjarje ndodhi, mund të thuhet që Presidenti Thaçi në të vërtetë ka qenë dirigjenti i kësaj ngjarjeje të rëndë. Pse po e them këtë? Ju e dini që me Kushtetutën tonë Thaçi nuk ka pasur fare nevojë të marrë Driton Gashin si këshilltar, lexojeni me vëmendje Ligjin për AKI-në. Ligji për AKI-në thotë: “Në

mënyrë kushtetuese drejtori i AKI-së është këshilltari i Presidentit, drejtpërdrejtë”, domethënë çka di Driton Gashi, duhet të dijë Hashim Thaçi automatikisht, me Kushtetutë, me ligjet tona në fuqi. Domethënë ligji thotë që Driton Gashi sa ka qenë drejtor i AKI-së, ka qenë drejtpërdrejt këshilltar i Hashim Thaçit. Tash, Ramushit s’i kanë kallëzuar, Memli, ai po thotë, mirë i të dyve, por njërit i ka kallëzuar, tjetri po thotë “s’po di sen”. Tash, sa i përket përgjegjësisë, e vetmja mendoj që ka mbetur të vërtetohet prej institucioneve tona të gjyqësisë është kjo: a e ka thirrur Hashim Thaçi Driton Gashin dhe ia ka dhënë urdhrin, apo Driton Gashi e ka bërë këtë ngjarje krye më vete.

Ky raport që do të votohet sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës është edhe një test për drejtësinë, aty ka material shumë relevant për ndonjë prokuror të guximshëm, i cili ende nuk e di a ekziston në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Raporti që po e trajtojmë sot është shumë korrekt, është raport i saktë, përfundimet dhe rekomandimet janë një bazë e fortë për ndryshimet e domosdoshme të kornizës ligjore që e rregullon këtë materie dhe unë do të thosha, ndoshta edhe një pistë shumë e përshtatshme për të adresuar përgjegjësitë e njerëzve që kanë qenë të përfshirë në këtë operacion.

Thashë, ndoshta është raporti më cilësor që është prodhuar, shkruar ndonjëherë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe si të tillë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës pa asnjë dyshim do ta votojë në unison. 31 shkeljet që janë evidencuar në raportin që po e trajtojmë sot, të nderuar kolegë deputetë, janë argumentuar në komision një për një dhe unë mendoj që janë tepër të qëndrueshme. Ndërkaq se kush ka qenë i informuar për operacionin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq, se kush e ka ditur dhe nuk e ka ditur, se kush ka qenë urdhërdhënësi, nëse ka qenë urdhërdhënësi ose nëse mbas gjithë kësaj batërdie ka qëndruar Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, unë nuk e di, ne nuk e dimë, por në fakt, duhet ta pranojmë të gjithë këtu që Komisioni Hetimor nuk ka arritur të argumentojë asnjëherë prej këtyre pretendimeve. Prandaj, deklaratat, ose diskutimet këtu që u dëgjuan, se kush është urdhërdhënësi, se kush ka qenë i informuar, e tjerë, e tjerë, ato janë observime individuale, personale, të deputetëve veç e veç dhe unë vlerësoj që nuk janë pjesë e raportit dhe nuk i ndihmojnë votimit të raportit.

Kjo çështje ka qenë bërë çështje politike dhe e përplasjeve kryesisht ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës dhe dy partive opozitare, edhe në Komisionin Hetimor dhe unë i ftoj të dyja palët që të gjykojnë me kokën e ftohtë ta trajtojnë raportin dhe eventualisht ta japin votën e tyre pro ose kundër. Thashë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në unison, por unë druaj, kam frikë se qysh kanë filluar të zhvillohen debatet rreth kësaj teme, do të rrezikohet edhe votimi i këtij raporti, që do të ishte shumë i dëmshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së, deputeti Frashër Krasniqi.

FRASHËR KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përgjatë historisë së vonë, botërore sidomos, sa herë që një shtet ka vendosur ta suspendojë ligjin dhe t'i shkelë të drejtat e njeriut, këtë gjithmonë e ka bërë në emër të ruajtjes së sigurisë kombëtare. Ne dimë raste kur me të vërtetë siguria kombëtare ka qenë e cenuar dhe ka kërkuar një suspendim të tillë, mirëpo është esenciale të theksohet që koncepti i gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të rrezikimit të sigurisë kombëtare më shpesh është përdorur për të arsyetuar shkeljen e të drejtave të njeriut, se sa që me të vërtetë siguria kombëtare ka qenë e cenuar.

Po ashtu, e dimë që të gjitha vendet jodemokratike që marrin vendime arbitrare, e shpeshherë edhe çnjerëzore, veprimet e tyre i arsyetojnë gjithmonë në emër të ruajtjes së sigurisë kombëtare e shtetërore dhe, në të gjitha rastet, kur një institucion dëshiron ta fshehtë një informacion që përbën skandal për të, këtë e arsyeton që gjoja zbardhja e këtij fakti, e këtij dokumenti, e këtij rasti, do të përbënte kërcënim prapë për sigurinë dhe interesin kombëtar.

E dimë po ashtu, të dashur deputetë, që në vendet jodemokratike që i shkelin liritë dhe të drejtat e qytetarëve të vet, drejtësia nuk ndahet përmes prokurorive e gjykatave, por përmes shërbimit sekret shtetëror, të cilit i nënshtrohet çdo institucion tjetër i sigurisë. I përmenda këto, sepse më 28 mars të vitit 2018, në emër të ruajtjes së sigurisë kombëtare në Republikën e Kosovës u krijua një precedent shumë i rrezikshëm i pasigurisë juridike e njerëzore, u krijua një precedent shumë i rrezikshëm, ku Agjencia e Inteligjencës që ka mandat vetëm vrojtues, merr rolin ekzekutiv dhe udhëheqës, duke shkelur ligjin dhe të drejtat e njeriut, pa dokumente, në shpërputhje me procedurat dhe i depërton 6 shtetas të huaj që po qëndronin në Kosovë në përputhje me ligjin.

Më 28 mars të vitit 2018, në Republikën e Kosovës u suspendua Kushtetuta, u suspendua Prokuroria, Gjykatat, Policia, e madje edhe vetë Qeveria dhe punët i mori në dorë Agjencia Kosovare e Inteligjencës. Ne e dimë mirë çka ndodh në një shtet ku shërbimi informativ i merr punët në dorë.

Unë e dëgjova këtu përfaqësuesin e PDK-së, duke u ankuar për faktin që raporti i Komisionit për Hetimin e shtetasve turq doli në publik dhe po, nuk jam dakord me protagonizmin e drejtuesve të komisionit, mirëpo nuk po e kuptoj aspak shqetësimin e PDK-së dhe të Hashim Thaçit nga fakti se raporti doli në medie. Tash e disa muaj na kanë thënë se transparenca në këtë proces përbën rrezik për sigurinë e Kosovës, por tash e disa muaj raporti veç është në publik dhe kurrfarë rreziku nuk pati Kosova, kurrfarë dëmi nuk pati Kosova. Pse pra gjithë kjo zhurmë për

publikimin e këtij raporti? Pse gjithë ky shqetësim që publiku ta kuptojë të vërtetën mbi këtë proces?

Të nderuar deputetë,

Idetë e mia politike dhe filozofike nuk përputhen aspak dhe madje janë në kundërshtim me ato të 6 shtetasve turq, që janë deportuar, po aq sa nuk përputhen dhe janë në kundërshtim edhe me të arrestuarit e tyre. Unë po ashtu i kuptoj situatat kur në Kosovë mund të cenohet siguria kombëtare dhe institucionet duhet të veprojnë për të na mbrojtur. Por, çfarë rreziku kaq të madh paskan përbërë këta gjashtë turq për sigurinë kombëtare në Kosovë që të dëbohen brenda një dite dhe me një shpejtësi të paprecedent, si dhe si është e mundur që Kosova qenka cenuar kaq shumë në aspektin e sigurisë kombëtare, e për këtë gjë nuk qenka njoftuar fare as kryeministri?

Këto janë disa çështje që të lënë të nënkuptosh që ky ka qenë një proces politik për pazare, favore ndërmjet politikanëve të caktuar në Kosovë dhe politikanëve të caktuar jashtë Kosovës. Çka na garanton neve që nesër për të ruajtur interesat e veta, për t'i larë borxhet e për t'u bërë favore miqve të tij nëpër botë, Hashim Thaçi nuk do t'i japë urdhër prapë AKI-së që të arrestojë e të deportojë njerëz prapë në emër të ruajtjes së sigurisë kombëtare? Çka na garanton që koncepti i ruajtjes së sigurisë kombëtare nuk do të përdoret sërish për të suspenduar të drejtat dhe liritë e njeriut në Kosovë, edhe për të gjithë ne qytetarët e Kosovës, jo vetëm për shtetasit e huaj.

Të nderuar deputetë,

Me vendimin e 28 marsit institucionet e sigurisë dhanë precedent shumë të rrezikshëm, duke e rreshtuar Kosovën në vendet ku politikanët mund të shpikin situata të jashtëzakonshme për të marrë vendime arbitrare dhe jodemokratike. Sot ne duhet të krijojmë një precedent tjetër, duhet ta votojmë këtë raport të përgatitur në mënyrë të shkëlqyeshme dhe kështu të dëshmojmë që praktikatat e suspendimit të të drejtave të njeriut për interesa personale e favore joparimore të politikanëve nuk mund të kalojnë dhe nuk mund të bëhen diçka normale dhe e zakonshme.

Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët e këtij Kuvendi që në mënyrë që ta rreshtojmë Kosovën në një shtet që i respekton të drejtat e njeriut dhe nuk krijon precedentë ku shkelen këto të drejta, ta votoni këtë raport të këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Lista serbe s'ka asnjë përfaqësues në sallë. Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate, deputeti Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë, si anëtar i Komisionit Hetimor jam munduar të bëj punën time si duhet, që e drejta e pesë shtetasve turq të zbardhet dhe që shteti ynë të dalë sa më mirë në respektimin e të drejtave të njeriut. Përgjatë punë sonë kemi vërejtur se ka pasur shumë shkeljet të zinxhirit të përgjegjësive institucionale dhe përzierje të kompetencave të institucioneve, si dhe anashkalimi i

shumë institucioneve në dëbimin e shtetasve. Prokuroria e gjykata nuk janë përfshirë në këtë proces, këtë e vërteton edhe raporti ynë, që është dashur nga institucionet që janë përfshirë në këtë proces të njoftohen edhe të dy institucionet dhe të kryhen të gjitha procedurat e rregullta ndaj pesë personave të dëbuar sipas ligjeve në fuqi dhe jo të shkelen të drejtat elementare të shtetasve në këtë operacion.

Ne si komision nuk kemi parë as edhe një shkresë nga shteti i Turqisë që është kërkuar personave që të dëbohen në shtetin e tyre, pos një vlerësim i Agjencisë për Inteligjencë, i cili vlerësohet se pesë shtetasit turq rrezikojnë sigurinë nacionale të vendit tonë.

Në anën tjetër, shohim se shteti i Turqisë çdo ditë kërkon dëbimin e shumë shtetasve të vet nga shteti ynë, si dhe mbylljen e shumë institucioneve shkollore në Kosovë dhe ne si institucione të Kosovës dhe si shtet një herë nuk kemi pasur një përgjigje për kërkesën e shtetit të Turqisë lidhur me aktivitetet e këtyre institucioneve në Kosovë dhe mund të konstatojmë se ne si shtet nuk i kemi dhënë një përgjigje shtetit tonë mik në kërkesat e tyre, që i kanë çdo ditë ndaj shtetit tonë, por kemi vepruar në mënyrën më të keqe, duke shkelur të drejtat e njeriut në rastin e dëbimit të shtetasve turq dhe duke vepruar me institucionet tona të sigurisë, sikur ato të jenë joprofesionale në kryerjen e detyrave të tyre apo sikur të mos kishte bazë ligjore në Kosovë. Në këto veprime që ka bërë shteti ynë, e për mua është një veprim shumë i gabuar dhe i papranueshëm, prandaj duhet theksuar se ky raport as nuk konstaton dhe as nuk vërteton vlerësimin e AKI-së se “personat në fjalë paraqesin kërcënim ndaj sigurisë kombëtare”. Në mënyrë që të vërtetohet, ose të konstatohet se ky vlerësim do të duhet të analizojë përmbajtjen e shkresës së AKI-së, të cilat përmbajnë informacione të klasifikuara, megjithatë edhe pa analizuar përmbajtjen e shkresës, konsiderohet se tri provat e lartcekura, të cilat kanë qenë në dispozicionin e komisionit, janë më se të mjaftueshme për të vërtetuar se çfarëdo kërcënimi që mund të kishin paraqitur personat në fjalë, ai kërcënim nuk është i natyrës terroriste ose i dhunshëm.

Sipas interpretimeve ligjore për tre zyrtarët revokimi i leje qëndrimit të shtetasve në fjalë është i detyrueshëm pas pranimit të shkresës nga AKI-ja. Në bazë të këtij interpretimi, ato nxorën vendime për revokimin e leje qëndrimit me automatizëm, domethënë pa analizuar vetë nëse informacionet e atyre shkresave të AKI-së plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për të qenë kërcënim ndaj sigurisë kombëtare.

Të gjitha vendimet për revokimin e leje qëndrimeve u nënshkruan nga dy zyrtarë. Pas nxjerrjes së vendimit për revokimin e leje qëndrimit, DSHAM-ja nuk mori masa menjëherë për t'i njoftuar pesë shtetasit turq lidhur me këtë vendim. Në fakt, është konfirmuar nga dy pjesëmarrës të takimit në fjalë, së pari, gjatë dëshmisë së Gudës para komisionit, kur ai u pyet nëse Policia ishte angazhuar për të siguruar biletat e udhëtimit, mes tjerash, për të dëbuar, ai u përgjigj: “Ne nuk kemi ofruar, sepse Agjencia e Kosovës për Inteligjencë e ka bërë gjithë aranzhimin për atë”, që për mendimin tim është një shkelje ose ndërhyrje në të drejtat e institucioneve të tjera.

Në rastet e tjera natyrshëm që Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për shtetësi, migrim dhe azil kujdeset për këtë logjistikë. Infrastruktura për dëbimin në këtë rast, konstatoj se Ministria e Punëve të Brendshme, së bashku me Policinë e Kosovës, nuk e kanë kryer punën në baza ligjore në fuqi për deportimin e shtetasve të huaj nga vendi ynë.

Andaj, ne si Grup Parlamentar i Nismës për Kosovën kemi dhënë kontributin tonë në raportin tonë dhe mendoj se raporti është jashtëzakonisht i mirë dhe i përpiluar dhe besoj te deputetët e Nismës që do ta votojmë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë para se të filloj fjalimin tim, dëshiroj t'u bëj pyetje iniciatorëve të kësaj seance: A mos jemi në ndonjë gjendje të jashtëzakonshme? Pse jemi thirrur sot me kaq urgjencë?

Thirrja kaq e ngutshme për seancë të sotme m'u duk sikur jemi në gjendje lufte me ndonjë shtet armik të madh. Neni 38 i Rregullores së Kuvendit e parasheh se mund të kemi seancë të jashtëzakonshme kur ka për t'u shqyrtuar një çështje e ngutshme. Prandaj, duke u nisur nga ky parim i çështjes së ngutshme, unë pyes: Çka përmban ky raport që na mbledh neve sot në seancë të jashtëzakonshme?

Unë mendoj se nuk ka asgjë të rëndësishme, sepse kjo çështje është rregulluar me anë të komisionit përkatës, por unë si përfaqësues i popullit mund të them se kemi pasur punë shumë më të rëndësishme, më urgjente nga kjo që sot jemi këtu. Dhe, ai është miratimi i ligjeve, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në rregullimin e jetës së qytetarëve të vendit tonë dhe institucionet tona. Por, duke anashkaluar këto, opozita vazhdimisht ka munguar në seancat për votimin e ligjeve vitale dhe si pasojë e mungesës së tyre nuk ka pasur kuorum për votimin e ligjeve, e tash na thërrasin neve në seancë të jashtëzakonshme për një temë, e cila është shumë e zakonshme për komisionin dhe institucionet tona.

Tërë kjo ka ndonjë prapavijë ose qëllim jo të mirë. Numër një, të ulet reputacioni i shtetit tonë, dëmtimi i raporteve të shkëlqyeshme midis Kosovës dhe Turqisë, të sulmohet pa nevojë presidenti i Kosovës, i cili iu përgjigj thirrjes së komisionit, i cili nuk ka marrë përgjigje për punën e komisionit, të tregohet mosrespektimi dhe ulja e kredibilitetit ndaj institucioneve tona.

Të nderuar, ne e dimë mjaft mirë se neni 71, i cili taksativisht e rregullon punën me veprimin e komisionit parlamentar dhe komisioneve të tjera, çka përmban. Por anëtarët e komisionit nga radhët e opozitës, ata të cilët sot na thërrasin këtu, fare nuk e kanë respektuar këtë komision, duke mos marrë pjesë në mbledhje dhe duke shkaktuar mungesë të kuorumit dhe duke treguar

joseriozitet. E sot, ata na e bëjnë këtë çështje shumë serioze dhe e trajtojnë si çështje e rëndësishme. Po të ishte kaq serioze dhe e rëndësishme, atëherë iniciuesit e kësaj seance do ta trajtonin ashtu edhe në mbledhjen e komisionit.

Raporti i përpiluar nga ana e komisionit është një raport fatal e dështim juridik, në të cilin vetë komisioni ka bërë gabim me angazhimin e ekspertit ndërkombëtar, pikërisht ku e ka caktuar një ekspert nga Amerika dhe këtu kemi konflikt, sepse Amerika është shteti i cili strehon kryesorin e kësaj organizate terroriste. Ne presim që njëjtë të jetë paanshme dhe transparent. Unë po ju pyes juve, a ka logjikë që dikush që të strehon kryesorin e organizatës terroristëve, e pastaj të bëjë një ekspertizë të besueshme?

Të nderuar, për këtë temë vazhdimisht po përmenden të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, por unë mendoj se kjo nuk ka të bëjë me të drejtën apo liritë themelore, por ka të bëjë me terrorizmin, një virus i cili i shkakton dëm të pariparueshëm në tërë botën. Prandaj, unë u bëj apel të gjithëve që këtë çështje ta trajtojnë në këndvështrimin e luftimit të terrorizmit, e jo të të drejtave ose lirive të njeriut. Por, edhe nëse shikohet nga këndvështrimi i lirive dhe të të drejtave të njeriut, organizata dhe pjesëtarë të organizatës “Feto” në natën 15 korrikut janë ata që brenda disa orëve kanë qenë shkaktarë të vdekjes së 250 personave të pafajshëm, ku në mesin e tyre kishte gra, fëmijë, persona me aftësi të kufizuara, e të tjerë. Në lëndimin e mbi 2500 personave, të cilët me të vetmin qëllim kanë dalë për të mbrojtur shtetin e tyre. Atëherë, le të flitet edhe kjo shkelje flagrante e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Gjatë dëbimit të gjashtë pjesëtarëve ‘Fetos’ nga shteti amë, ky ka të bëjë vetëm me terrorin dhe luftimin e terrorizmit dhe nuk është diçka shqetësuese, sepse me të drejtën ndërkombëtare dhe marrëveshjen midis shteteve, kjo është në rregull. Po të shikohet edhe protokollin shtatë i Konventës Evropiane të Lirive dhe të Drejtave të njeriut, paragrafi 2, e parasheh se ndër të tjera ky dëbim është i domosdoshëm në interesin e vendit publik apo është bërë për arsye të sigurisë kombëtare, në të cilën unë besoj. AKI-ja dhe Policia e Kosovës kanë pasur arsye të mjaftueshme për të vepruar.

Unë nuk jam jurist, as prokuror, as gjyqtar, por për të dëbuarit, nëse analizohet dhe hulumtohet mirë, do të vërehet se mbi bazën e çfarë vepre penale janë duke u gjykuar në Turqi. Është aktakuza me qindra apo mijëra faqe, ku detajisht sqaron se kanë lidhje direkte në lidhje me puçin në Turqi. Unë publikisht u bëj thirrje komisioneve përkatëse që të marrin pjesë në procesin gjyqësor, ku janë duke u gjykuar të dëbuarit nga Kosova, aq më tepër raporti në lidhje me dëbimin e shtetasve turq në asnjë rrethanë nuk ka përmendur që organizata terroriste ‘Feto’ se si ka bombarduar Parlamentin e Turqisë, si ka bërë shkelje marramendëse të lidhjeve dhe të drejtave themelore të njeriut dhe marrjen e shumë jetëve të personave të pafajshëm dhe lëndimin e tyre, ku para disa ditësh pikërisht deputetët nga radhët e Vetëvendosjes, në krye me Albin

Kurtin, ishte në vizitë në Turqi dhe është pritur në mënyrë madhështore në këtë Parlament, ku ishte bombarduar nga këta terroristë.

Pas shumë vërejtjeve ndaj institucioneve të Kosovës, unë dhe kolegja ime deputete, zonja Myfera Shinik, vazhdimisht kemi tërhequr vëmendjen se kjo organizatë terroriste është duke operuar edhe në Kosovë dhe se paraqet një rrezik potencial e urgjentisht duhet të ndërmerren masat e nevojshme. Në këtë raport kishim pritur edhe rekomandimet se si duhet vepruar ndaj kësaj organizate terroriste, jo vetëm vërejtje për institucionet tona.

Sa i përket çështjes së terrorizmit dhe kësaj organizate, ne mund të marrim shembull edhe 22 shtete të tjera në mbarë botën, si kanë vepruar ndaj kësaj organizate. Edhe shtetet në rajon të njëjtën e kanë bërë, po vetëm Kosova jo.

Ne si Grup Parlamentar 6+ jemi kundër miratimit të këtij raporti të njëanshëm dhe selektiv.

KRYESUESI: Deputeti Glauk Konjufca, si shef i Grupit Parlamentar. Dy minuta! Jo të gjithë, në emër të grupit...

GLAUK KONJUFCA: Jo, tash mos thuaj që s'ma përmende emrin, se u bërë pyetje këtyre që e kanë ngritur mocionin.

KRYESUESI: Nuk ka rëndësi vetëm emri. I është referuar përmbajtjes, kështu që keni të drejtë dy minuta.

GLAUK KONJUFCA: E para, zoti Damka, këtu nuk je në Parlament të Turqisë, por je në Parlamentin e Republikës së Kosovës. Ky është dallim elementar për ta bërë kur të dalësh në foltore.

E dyta, ne të ftojmë, të gjithë si deputetë të Republikës së Kosovës, të mos e keqpërdorësh foltoren për të sulmuar një raport shumë të rëndësishëm në mes të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo është e dyta.

E treta, unë e thashë në hyrje të fjalimit tim, raportet me Turqinë i shohim nga prizmi i barazisë, reciprocitetit dhe interesave të dyanshme. Kurse, kjo që ka ndodhur me deportimin e shtetasve turq, është raport i vasalitetit dhe i nënshtrimit, kur ti u nënshtrohesh plotësisht urdhrave të një shteti tjetër. Kështu nuk duhet të ndërtohen raportet mes Kosovës dhe Turqisë. Ky është raport i pabarazisë dhe i nënshtrimit, edhe është turp nëse ti i kontribuon atij raporti, të nënshtrimit dhe të vasalitetit. Ne jemi për marrëdhënie të shkëlqyeshme me Turqinë, gjithmonë do të jemi dhe gjithmonë ne do ta dallojmë Turqinë nga pushteti në Turqi. Pse, zoti Damka?

Sepse mund të jetë Erdogani, por nesër nuk është, e Turqia vazhdon të jenë. Kosova gjithmonë do të ketë interes për marrëdhënie të shkëlqyeshme me Turqinë, por jo aso marrëdhënie të shekujve 15 e 16, por të shekullit 21, raporte të barazisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë nuk e di Glauku pse aq shumë është shqetësuar për fjalimin tim. Unë jam deputet i Kuvendit të Kosovës dhe flas unë qysh mendoj. Kurrkush s'mund të më ndal, se e kam të drejtën kushtetuese të jem deputet në këtë Kuvend të Kosovës, së pari. Edhe së dyti, unë mund ta kritikoj edhe raportin, edhe marrëdhëniet mes raportit e me do shtete të tjera, ky është mendimi im. Dhe, puçi nuk është bërë për Erdoganin, por është bërë për shtetin e Turqisë, ta dallojmë këtë çështje. Në atë puç kanë sulmuar Kuvendin e Republikës së Turqisë, ku janë edhe deputetët e opozitës, nuk janë vetëm deputetët e Erdoganit. Të lutem, të kemi sqarim për këtë çështje dhe të bëjmë dallim mes Erdoganit dhe shtetit të Turqisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Avdullah Hoti, replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Mandati i Komisionit Hetimor nuk ka përfshirë shqyrtimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Turqisë, as të Kosovës me SHBA-në, asnjë çështje të tillë. Mandati i komisionit ka qenë që të shqyrtojë procedurat ligjore se si është bërë deportimi i gjashtë shtetasve turq nga institucionet e Kosovës në Turqi, vetëm kaq. Unë besoj që nuk ka vend në këtë Kuvend, as në këtë seancë, që të devijojë debati tash në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Turqisë e vendeve të tjera. Unë ju lus të gjithëve që të koncentrohemi në të gjeturat e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i komisionit, zoti Sveçla, dy minuta!

XHELAL SVEÇLA: Veç një pjesë të përgjigjes e sqaroi zoti Hoti tashmë. Unë desha të përgjigjem në pyetjen e drejtpërdrejtë që ua bëri iniciuesve të këtij debati. Realisht është bërë një muaj që komisioni ka dorëzuar raportin Kryesisë së Kuvendit dhe me Ligjin për hetim parlamentar, siç e sqarova edhe më herët, brenda 30 ditësh Kryesia e Kuvendit është dashur ta sjellë në seancë të rregullt.

Ne kur e kemi parë mungesën e vullnetit të Kryesisë së Kuvendit për të diskutuar për këtë çështje, për ta hedhur raportin në votim, atëherë kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme dhe jo se kemi ndonjë situatë të jashtëzakonshme, por po ashtu duhet pasur parasysh edhe një fakt tjetër. Kjo ngjarje ka ndodhur me 29 mars 2018 dhe për shkak të obstrukcioneve dhe zvarritjeve të vazhdueshme, ne jemi në qershor të vitit tjetër dhe ende nuk i kemi shqyrtuar në tërësi të gjeturat e komisionit që është themeluar nga ky Kuvend. Dhe, siç u tha edhe më herët, mandati i

komisionit nuk ka qenë që të vlerësojë as ideologjinë, as veprimet e këtyre individëve në shtetin turk. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësues të Qeverisë nuk kemi në sallë. Do të vazhdojmë me deputetët sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ne e kemi raportin e Komisionit hetimor, të cilin besoj se shumica e konsiderojnë të saktë dhe të besueshëm. Përkundër kësaj, për shkak të natyrës së punës së AKI-së dhe kufizimeve për të ushtruar kontroll dhe mbikëqyrje të plotë demokratike, ne nuk arritëm të siguronim fakte të drejtpërdrejta se a ishte operacioni për dëbimin e gjashtë shtetasve turq si parandalim i rrezikimit të sigurisë nacionale, apo a ishte operacion i kërkuar nga ndonjë autoritet më i lartë shtetëror të Kosovës apo të autoritetit të ndonjë shteti tjetër. Prandaj, duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, unë do të provoj të qartësoj dilemat e ngritura, duke sjellë para jush shpjegimet të cilat janë metodat, autorizimet, procedurat dhe protokollet e agjencive inteligjente për operacionet e natyrës së tillë.

Një agjenci e inteligjencës e ka për detyrë që me autorizimet ligjore, të sigurojë informata për shtetas të huaj, si individë, apo si grupe, si dhe organizata të natyrave të ndryshme, që me punët dhe aktivitetet e tyre, a i respektojnë kushtetutën, ligjet dhe traditat e vendit ku ata qëndrojnë për arsye të ndryshme.

Bazuar në indikacionet e para se një shtetas i huaj apo disa të tillë ushtrojnë veprimtari kriminale, terroriste apo armiqësore, hapi i parë që duhet të ndërmerret agjencia përkatës është, me burimet e vogla njerëzore, financiare dhe teknike, të përpiqet të vërtetojë saktësinë e informatave. Nëse arrijnë të vërtetojnë se informata është e saktë dhe individ i apo grupi paraqet rrezikshmëri të lartë, atëherë agjencia ngre një grup të veçantë, të cilit duhet t'i vihen në dispozicion të gjitha kapacitetet që posedon agjencia dhe fillon menjëherë bashkëpunimi intensiv me Prokurorinë dhe Policinë e Shtetit.

Operacioni kodohet me ndonjë emër, klasifikohet sipas shkallës së sekretit dhe qasje duhet të kenë vetëm të autorizuarit për pjesën e vet të përgjegjësisë. Agjencia për shkak të kufizimeve në personel, angazhon edhe ekspertë të fushave të ndryshme, siç janë: njohësit e gjuhës dhe dialekteve, ideologjive dhe besimeve, gjurmuesit e rrjedhës së parasë apo transaksioneve, ekspertët e IT-së etj.

Nëse grupi nën hetim është i madh, atëherë task-forca e agjencisë duhet të ketë gjithëpërfshirje më të madhe, në mënyrë që të realizohet një bashkërenditje e mirë e personelit, mjeteve dhe teknikave të lidhura me kohën dhe vendet për zhvillimin e operacionit. Me fillimin e operacionit,

të autorizuarit, çdonjëri në fushën e vet, duhet të sigurojnë filmime, fotografi, përgjime, përkthime, infiltrime, biseda me dëshmitarë, të analizojnë raportet e bankave dhe organizatave financiare, të zbërthejnë tërë rrjetin, të zbulojnë bashkëpunëtorët vendas si dhe të shtrijnë bashkëpunimin me shërbimet e tjera mike në rajon dhe më gjerë.

Ndërkohë, ekspertët ligjorë në çdo kohë bëjnë vlerësime ligjore në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, privatësisë dhe identifikimin e shkeljeve ligjore. Në momentin e vlerësuar, në bazë të të gjeturave të agjencisë, me autorizimin e prokurorit, rolin ekzekutiv e merr policia, të cilët bëjnë izolimet e lokacioneve, ndalime, arrestime, shoqërime, bastisje të vendeve të banimit, punës dhe automjeteve, konfiskojnë dokumente, kompjuterë, telefona, fotoaparate, kamera etj.

Të dyshuarit duhet të njoftohen me të drejtat e tyre si dhe të procedojnë në stacione për identifikimin e mëtejshëm. Gjatë zhvillimit të operacionit, individëve nuk u mohohet e drejta për mbrojtje ligjore, dhe shërbime mjekësore. Varësisht nga vlerësimi i rrezikshmërisë së të dyshuarve, bëhet edhe angazhimi i njësisë të policisë, filluar nga ato të rëndomtë e deri te njësitë më elitare. Në raste të tilla, në gatishmëri të plotë duhet të jenë edhe ekipet mjekësore dhe të zjarrfikësve.

Operacioni do të duhej të synonte që të gjithë të implikuarit në veprimet antikushtetuese dhe ligjore të silleshin para organeve të drejtësisë, bazuar në forcën e fakteve dhe argumenteve. Në momentin që operacioni përfundon dhe rasti fillon të trajtohet nga organet e drejtësisë, zyrtarët e institucioneve të implikuara veç e veç apo së bashku bëjnë publike rrjedhën e tij, duke argumentuar dhe shpalosur faktet për qytetarë, për të bërë transparent operacionin, i cili ta zëmë se ka parandaluar rrezikimin e sigurisë nacionale.

Për një operacion të tillë, policët, agjentët, zyrtarët e drejtësisë do të vlerësoheshin lart nga mirënjohjet dhe duartrokitjet e qytetarëve. Ata sigurisht se do të ndjeheshin të sigurt për veten, familjet dhe shtetin e tyre. Kështu veprohet në shtetet normale, kur institucionet janë bashkëpunuese, bashkëvepruese, profesionale, llogaridhënëse dhe të kontrollueshme.

A ishte kështu në rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq? Jo! Asnjë nga hapat e cekur më lart nuk ka ndodhur.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në arkivin e AKI-së nuk do të gjeni asnjë gjurmë nga filmimet, përgjimet, përkthimet, analizat, konsultimet dhe vlerësimet për aktivitetin e gjashtë shtetasve turq. Ata u cilësuan si terroristë, për momentin paqësor, por ideologjikisht të rrezikshëm për të ardhmen. U arrestuan nga policët e rëndomtë. Për më tepër, që disa prej tyre ishin edhe me probleme shëndetësore. Dhe pas disa xhirove andej-këndeje, ia dalin t'i dorëzojnë në aeroport, te sektori i VIP-ave ku priste një

aeroplan për të cilin askush nga autoritetet tona nuk e kishte idenë pse dhe si ai aeroplan gjendej aty.

Shtetasit turq ishin ligjërues dhe mjek me dokumente të rregullta të qëndrimit dhe punës, familjarë të moshës së mesme. Nuk i rezistuan arrestimeve, askush nuk iu komunikoi arsyen e arrestimit. Ata ishin të hutuar, por të qetë dhe nuk i rezistuan as nuk tentuan të iknin. Me pamjen, sjelljen, kulturën e komunikimit, punën që ushtronin, nuk linin përshtypjen se ata mund të ishin terroristë.

Zonja dhe zotërinj,

Gjashtë shtetasit turq u dëbuan në mënyrën më primitive. Këto akte ndodhin vetëm në vendet ku sundojnë huntat ushtarake, apo diktatorët. Një dramë e tillë e frikshme mund të realizohet vetëm në shtetet ku shërbimet inteligjente janë instrument dhe krejtësisht në duar të ndonjë pushtetari. Kam frikë se e njëjta gjë ndodhi edhe te ne.

Vetëm falë mediave dhe reagimit të opinionit, ky operacion u ndërpre. Përndryshe, sipas ish-drejtorit të AKI-së, operacioni parashihte të dëboheshin rreth 200 shtetas turq. Gjatë intervistimit ish-drejtori insistonte që vlerësimi i AKI-së ishte se këta persona paraqisnin rrezik për sigurinë nacionale e jo që ndonjë autoritet tjetër e ka hartuar listën për t'i dëbuar në Turqi. Por, veprimet tregojnë të kundërtën. E them me përgjegjësi të plotë se AKI-ja fare nuk zhvilli operacion të vlerësimit, por thjeshtë zbatoi urdhrat nga lart. Shtrohet pyetja si është e mundur që 194 shtetas turq që i shpëtuan dëbimit nuk qenkan tani më të rrezikshëm për sigurinë nacionale të Kosovës.

Është çështje e prokurorit të zbulojë të vërtetën. Të vërtetojë implikimin e çdo zyrtari shtetëror, filluar nga Presidenti e deri te zyrtari i fundit..

KRYESUESI: Faleminderit! 30 sekonda!

ANTON QUNI: Atë që nuk arriti të faktojë Komisioni Hetimor, mund ta bëjë vetëm prokurori, kuptohet. Nëse ka të tillë që nuk kanë frikë që edhe atyre nesër dikush mund t'ju trokasë në derë me etiketimin se është armik i popullit.

Krejt në fund, me rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq, ne botës demokratike i treguam se demokracia te ne është e brishtë dhe se jemi larg plotësisht të parakushteve që të ndërtojmë shtet demokratik.

Me këtë rast, ne shkelëm madje edhe disa prej parakushteve që janë vlerat tona, që i bartim si komb, e me të cilat ndiheshim krenarë, siç janë mikpritja dhe fjala e dhënë, besa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

U tha edhe nga disa prej parafolësve që përsëri jemi në një seancë të jashtëzakonshme për një raport të cilin ka javë të tëra që e kemi parë, një version të tij edhe në media, e pastaj ka javë të tëra të cilin e kemi marrë. Ka javë të tëra që është përfshirë në rend të rregullt të ditës dhe që s'është kaluar dhe realisht unë t'ju them të drejtën kjo vetëm e dëshmon atë që secilën seancë të jashtëzakonshme, ju si opozitë po dëshmoni që keni mbetur pa tema, keni mbetur pa kauzë, keni mbetur pa agjendë dhe mandej po kapni diçka për t'u munduar të bëni lajmet e ditës, që është për keqardhje.

Shumë më urgjente sot ka qenë të thirret një seancë për të kaluar ligjin për tatime në korporata, të cilin ju si LDK dhe ju si Vetëvendosje jeni duke e pamundësuar të kalojë, duke ua pamundësuar sportistëve të Kosovës, artistëve të Kosovës dhe të rinjve të Kosovës të marrin benificionet të cilat shteti duhet t'ua garantojë. Dhe përkundër të disa herë e kemi nxjerrë në votim, ju nuk merrni pjesë në votim, ju e kundërshtoni këtë ligj, a realisht ajo është temë për mendimin tim personal njëqind herë më urgjente se janë me dhjetëra mijëra sportistë të Kosovës, artistë edhe të rinj që i kanë sytë nga ky Kuvend dhe të njëjtit njerëz që i keni thirrur në këtë seancë nuk keni kurajë t'u dilni ndihmë ashtu siç po i dalim ne si koalicion qeverisës dhe të jepni votën në favor të tyre.

Ajo është temë urgjente. Ajo është temë më urgjente se kjo, se ky raport do të miratohet qoftë sot, qoftë pas një jave, qoftë pas një muaji dhe nuk ka ndonjë ndikim drejtpërdrejt në procesin hetimor të cilin duhet pa dyshim sa më shpejt ta kemi të përfunduar, në mënyrë që t'i jepet qartësim kësaj teme. Se kjo çështje është shumë e rëndësishme, edhe ka nevojë edhe duhet të qartësohet njëherë e përgjithmonë. Të hiqen krejt këto implikime dhe manipulime, të cilat edhe sot për fat të keq, edhe në kundërshtim me raportin që e kanë përgatitur pikërisht këta që dolën me fol në pjesën, këtu folësit e parë, realisht e kanë në kundërshtim me të. Andaj po, është shumë me rëndësi të kalojë sa më shpejt edhe t'i lihet hapësirë organeve të drejtësisë të kryejnë punën e vet.

Ky proces për këtë komision edhe për punën e këtij komisioni ka pasur mbështetje unanime në këtë Kuvend prej krejt partive politike, me besimin që me të vërtet do të jetë një hetim parlamentar, i paanshëm dhe objektiv për të mund të nxirret një raport, i cili do të jetë edhe sqarues, edhe ndihmues. Realisht qasja paragjyquese e udhëheqësve të Komisionit e ka dëmtuar këtë raport. Qasja paragjyquese e cila u tha edhe sot në foltoren e Kuvendit, përkundër asaj që në raportin e tyre nuk thuhet asnjë fjalë implikimet që këta sot i nxorën për personat qofshin në udhëheqjen e shtetit apo në nivelin e shërbimit civil.

D.t.th. edhe sot zotërinj anëtarë të Komisionit deklaruar në Kuvend të Kosovës gjëra që s'janë në raport. Tash, a keni ardhur për ta miratuar raportin, a keni ardhur prapë për të manipuluar për të dalë në lajme të sotme? Keni ardhur për të dalë në lajme, s'keni ardhur për të miratuar raportin,

sepse raportin kemi mund të pajtohem me nga një fjalë të secilit përfaqësues të grupeve parlamentare dhe të qitet në votim, po ju s'doni ta votoni raportin se i keni edhe njëzet vetë të flasin sot dhe e dini si ndodh në këtë Kuvend, pas pauzës gjysma e njerëzve të juaj s'kanë për t'u kthyer edhe s'do të keni kuorum. Por është evidente që s'e keni dertin aty realisht.

Për raportin ka çka të thuhet dhe çka do që të flasim ne sot, kemi për të dashtë t'ia keqinterpretojmë njëri-tjetrit, qysh edhe u keqinterpretuam qëllimshëm, qoftë dikush i pozitës së juaj, qoftë ju të opozitës dikë prej neve. Por, e vërteta është që e dini edhe ju dhe s'mund ta mohoj askush që, përkundër punës që është bërë dhe s'duhet mohuar asnjëherë punën e këtij Komisioni, ka pasur shkelje procedurale. Dhe më e vogla që mund të thuhet është që pa pasur kuorum, janë intervistuar njerëzit dhe pastaj janë marrë si prova për t'i përfshirë në raport, thua se s'keni mundur të prisni të bëni kuorumin, që keni pasur shumicën e rasteve, për t'i përfshirë edhe ato prova. Po i zelli paragjykes i juve që keni udhëhequr këtë Komision, pa dyshim që ju ka penguar.

Raporti është i shkruar mirë absolutisht dhe 80 e sa faqe raport të shkruar mirë, sidomos pjesa që e përshkruan rrjedhën e punës etj. por, nuk është fer në një raport kaq të rëndësishëm të ketë interpretim selektiv të disa dispozitave ligjore, qofshin ato vendore, por edhe të konventave ndërkombëtare për t'u munduar të arrihet një qëllim. Nuk ju bën as juve nder, e as nuk i ndihmoni procesit. Në fund të fundit, nëse dikush ka për të kontestuar nesër, i keni dhënë hapësirë për ta kontestuar pikërisht për shkak të interpretimit selektiv dhe sot nuk dua që të keqinterpretohem qëllimshëm dhe t'ju tregoj cilat janë. Sepse, sidomos ju që jeni marrë në baza të rregullta me të e dini, e dini sepse ta zëmë ju keni kërkesa në këtë raport që të subordinohet Kushtetutën e Kosovës ndaj konventës ndërkombëtare. Ne i kemi internalizuar në legjislacionin tonë këto konventa, po nuk mund të kërkonim ta subordinoni Kushtetutën e këtij vendi.

Po më duket që është një kërkesë absurde, ashtu qysh nuk mendoj që mund të kërkonim po them figurativisht ta bëni Agjencinë Kosovare të Inteligjencës organizatë joqeveritare. Krejt fryma e këtij raporti është qysh AKI-ja duhet të merret me aktivitete, bile organizatat tona joqeveritare janë njëqind herë më aktive sesa qysh po lypni ju të jetë AKI-ja. Të mbledhë disa informata, çka të bëjnë ata, të lexojnë gazetat, të flasin me njerëz, të bëjnë vëzhgime edhe aq. Në asnjë mënyrë, ne e dimë që këto institucione që merren me inteligjencë nuk mund të kenë kompetenca ekzekutive në një shtet modern qysh është Republika e Kosovës. Po ideja juaj për ta cenuar të drejtën e AKI-së, realisht mandej ju ka shty që të shkruani në një raport që këta, s'po di çka ta quaj tjetër, përveç ndoshta njëfarë OJQ-e e butë që merret me aktivitete kushedi çfarë.

Andaj edhe vlerësimin që e keni bërë një pjese të legjislacionit, realisht është jashtë kompetencave të Komisionit. Në rregull është të jepen rekomandime, ndërroje këtë ligj, e ndërroje atë ligj, po vlerësimin legal që ai eksperti ose kushdo që e ka shkruar për legjislacionin, në njëfarë forme po e zhvlerëson punën e krejt legjislaturave të kaluara që janë bërë me ligje,

qoftë për Ligjin për të huajt, qoftë për ligje të tjera. Edhe rregullimin institucional ju jeni duke e zhvlerësuar me këtë raport. Dhe duke i marrë për bazë disa prej këtyre problemeve që unë personalisht në leximin që ia kam bërë këtij raporti, i konsideroj që janë të panevojshme, ju realisht dhe pjesën e mirë të raportit jeni duke e cenuar.

Po them jo tërësisht, po ka mangësi sikur këto që i përmenda të cilat janë duke e zhvlerësuar këtë raport dhe arsyeja kryesore po e përsëris është pikënisja me paragjykim. Komisionet hetimore janë tepër të rëndësishme në parlament dhe kjo është legjislatura që ka më së shumti komisione hetimore ndonjëherë që ka pasur. Janë edhe disa të tjera që besoj do të bëhen gjatë mandatin tonë, por realisht Komisioni hetimor parlamentar duhet të nisët pa paragjykim. Në momentin që ju keni nisur me paragjykim, me konkluzione, ju realisht e keni cenuar edhe paanësinë e punës së këtij komisioni, bile edhe duke mos e pranuar një raport kundërshtues në pika të caktuara nga kolegët e juaj, e që janë pjesë të grupit tonë parlamentar. S'e keni pranuar, s'e keni pritur as në takim. Për tre minuta e keni kryer mbledhjen. Ashtu kemi mundur edhe sot ta votojmë përndryshe, veç të ishit marrë vesh, ju thash, po s'keni ardhur për të votuar raportin, po keni ardhur për të mbajtur ders.

Organet e drejtësisë së Republikës së Kosovës duhet ta thonë fjalën përfundimtare për këtë punë. Kjo është një proces që pa dyshim është zhvilluar edhe është përcjellë me të meta, të cilat janë të pamohueshme. Pa dyshim që ka pasur probleme në krejt këtë aksion për të cilin nuk besoj që ka njeri që mund t'i kontestojë ato probleme dhe do të duhej të prokuroria, gjyqësori, krejt organet e drejtësisë, në mënyrën më efikase të mundshme, po shpresoj edhe të shpejtë të japin fjalën përfundimtare. Nuk jam i sigurt që ky raport mund të ketë farë ndihmese shumë të madhe në këtë drejtim, për arsyet që i thash, veçanërisht interpretimi selektiv, por unë shpresoj që interpretim selektiv në proces nuk do të ketë.

Dhe, kjo vetëm për të vetmen arsye, që ata njerëz të cilët janë depërtuar, familjarët e tyre ta kenë një drejtësi të cilën kanë nevojë, e mbi të gjitha shteti i Kosovës të mos mbetet peng i interpretimeve të palëve për këtë çështje, por nëse gabimet kanë ndodhur, ato mos të ndodhin më kurrë. Ky ka qenë qëllimi i secilit këtu. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, sekretari i Partisë Demokratike të Kosovës ka qenë njeriu më i zëshëm prej ditës, momentit kur është marrë vesh që ka ndodhur kjo. Por, paragjykimi me të cilin është përcjellë ky proces dhe kjo punë e këtij grupi, e ka humbur deri në një masë edhe validitetin apo kredibilitetin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Avdullah Hoti replikë, dy minuta!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Unë e përcolla me kujdes zotin Krasniqi. Është grupi i tij parlamentar, përfaqësuesit e grupit të tij parlamentar në këtë komision, është vetë ai personalisht, edhe kryetari i Kuvendit që vazhdimisht

e kanë sabotuar punën e këtij Komisioni. E di ai diskutimin që kemi pasur në Kryesi të Kuvendit para disa muajve kur kemi kërkuar, kur Komisioni ka kërkuar zgjatjen e afateve. Po pavarësisht këtyre, hajde po i lëmë krejt këto anash. Le të përgjigjet zoti Krasniqi a e mbështet grupi i tij parlamentar këtë raport, edhe unë menjëherë tash po bëj një mocion që të tërhiqemi nga debati dhe të shkojmë drejt në votim dhe ta votojmë këtë raport. Pra le të përgjigjet ai, nëse grupi i tij parlamentar e mbështet këtë raport, dhe unë po e qes mocionin menjëherë në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, një minutë!

MEMLI KRASNIQI: Zoti Hoti, ju e dini mirë qysh e kemi kaluar këtë komision, qysh kur është themeluar, edhe po ashtu edhe kur i është vazhduar mandati, edhe përkundër shkeljeve të shumta që ju i dini, ti bile i di saktësisht shkeljet të cilat janë bërë gjatë punës së këtij komisioni. I kemi tejkalluar edhe kemi ardhur këtu pikërisht pse jemi pajtuar që duhet të ketë një raport përfundimtar dhe një proces që ta përmbyllim dhe si Kuvend ta themi fjalën e fundit.

Qëndrimet tona unë i shpreha. E vërteta është që raporti si tërësi ka mangësi të cilat kanë ardhur si pasojë e paragjytimeve të udhëheqësve të këtij komisioni. Ky raport nuk e ka pranuar një raport kundërshtues, i cili me ligj është dashur t'i bashkëngjitet këtij raporti. Pse? Sepse këta e kanë mbajtur mbledhjen për tre minuta. Në rregull është. Deputetët e PDK-së do të votojnë për këtë farë raporti ashtu siç ata e vlerësojnë.

KRYEUSUESI: Glauk Konjufca, replikë në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Për besë në fjalimet i kemi paraqitur për arsye që ta bindim Memlin edhe kolegët e tij që ky raport është i mirë. Unë nuk e paskam ditur që Memli është i bindur që ky raport duhet të votohet edhe është i mirë. Tash që e mora vesh edhe prej fjalës së tij, ky është një lajm shumë i gëzueshëm për Kosovën, kështu që ne i tërheqim fjalimet tona dhe nëse janë të gatshëm edhe të gjithë të tjerët kështu, sikur LDK-ja dhe Vetëvendosja, dhe meqenëse të gjithë po pajtohemi që ky raport është shumë i mirë, atëherë unë me të vërtetë propozoj që të shkohet drejt në votim.

KRYESUESI: Memli Krasniqi, kundër-replikë.

MEMLI KRASNIQI: Ne e dimë Glauk që ju fjalimet i keni për arsye të tjera e jo për të ma mbushur mua mendjen, sepse sikur t'ia kishim mbushur në mendjen njëri-tjetrit, të gjitha ato fjalime i kemi mbajtur që ta kalojmë Ligjin për sponsorizime, për të cilin as nuk denjuat prapë të përgjigjeni, e juve prapë s'po ju mbushet mendja. Ju Vetëvendosja prapë po mendoni që është keq t'u ndihmohet sportistëve të Kosovës, dhe s'keni kurajë as në këtë rast, as në këtë rast të jepni votën. D.m.th. juve s'ju mbushet mendja për kurrgjë hiq. Edhe kur është mirë. por Unë ju

thashë, deputetët e PDK-së, marrin pjesë në votim dhe unë nuk do t'ua imponoj mënyrën sesi votojnë ata. Kjo për një arsye, sepse udhëheqësit e këtij komisioni në mënyrë jashtëzakonisht joparimore nuk e kanë lejuar që të përfshihet edhe raporti i tyre. Sikur të përfshihej ky raport, vota do të ishte pro pas asnjë diskutim, sepse do të ishin dy raportet bashkë.

Meqenëse kjo s'ka ndodhur, deputetët vendosin vet.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë në emër të komisionit, kush dëshiron? Zoti Sveçla në emër të Komisionit Hetimor. Pastaj Naser Osmani meqë është hapur dhe tema që lidhet me punën e grupit që e ka udhëhequr ai.

XHELAL SVEÇLA: Vetëm një sqarim! U përmend disa herë një e pavërtetë e cila ka shumë dëshmitarë të cilët mund të deklarohen këtu.

Të gjithë anëtarët e komisionit të cilët kanë qenë pjesë e mbledhjes së fundit kur është votuar raporti, është edhe procesverbali edhe stenogrami edhe incizimet, ku demantojnë të thënë e parafolësit se kinse dikush ka tentuar ta dorëzojë një raport shtesë apo një qëndrim kundërshtues në komision.

Normalisht se ne e dimë se kjo ka mundur të ndodhë, meqenëse edhe me Ligjin për Hetim Parlamentar jepet kjo mundësi, por në asnjë moment as pas miratimit nuk na është thënë kjo.

Është hera e parë që unë si kryetar i komisionit, por unë besoj që do të mund të deklarohen të gjithë anëtarët e komisionit, pra është hera e parë që ne po dëgjojmë një informatë të këtillë.

Prandaj, ju kisha lutur që të merreni me të vërtetën.

Unë nuk po dua që të replikoj pas çdo fjalimi, ku ka tendenca që të shmanget e vërteta apo për ta denigruar punën e komisionit, por kjo megjithatë është tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Kur flasim për të vërtetën, është mirë që ju kryetar i komisionit ta thoni të vërtetën e plotë.

Unë ju thashë dy-tri herë që s'keni lejuar, se për pesë minuta e keni kryer mbledhjen. Edhe bash ai stenogram, ai procesverbal, ai transkript e dëshmon këtë që po e them unë.

Jeni mbledhur, pesë minuta e keni kryeri mbledhjen dhe s'keni denjuar që të prisni edhe dy minutat tekefundit që të vijë anëtari i komisionit zoti Beqa që t'ua japë atë raport.

E pasi të kryhet puna, ju e di që nuk ka mundësi të dorëzohet një raport i tillë. Andaj, ju mund të arsyetoheni si të doni proceduralisht. Ju punën tuaj e keni kryer, bravo ju qoftë. E keni menaxhuar, dhe me atë që e ke menaxhuar, eja mblidhemi dhe e kryejmë për tre minuta.

Në rregull është legalisht, por në kuptimin parimor pas gjithë asaj pune që është bërë nuk keni mundësuar, s'po them s'e keni lejuar, po s'e keni mundësuar që të dëgjohet edhe fjala e dikujt tjetër aty.

KRYESUESI: Naser Osmani e ka fjalën. Dy minuta, replikë.
Një sqarim të shkurtër, në emër të komisionit, flet kryetari i komisionit.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryeses!

Konsideroj që po keqpërdoret foltorja sepse në rend të ditës e kemi një çështje krejt tjetër që ka të bëjë me një raport të një komisioni hetimor, dhe zotëri Memli paraqiti në sekuenca një të pavërtetë.

E vërteta është kjo që Ligjin për Tatime në të ardhura personale dhe në korporata e ka kryesuar Naser Osmani i LDK-së.

Drafti i është paraqitur komisionit, i cili e ka votuar në anonimitet e që e ka udhëhequr kryetari i komisionit Lumir Abdixhiku i LDK-së.

Drafti në fjalë nuk është hedhur në votim, në seancën që është kryesuar nga Xhavit Haliti i PDK-së. Është hedhur në votim, vetëm amendamenti i Bekim Haxhiut, deputetit të PDK-së.

Kanë qenë dy variante; një i komisionit që e ka mbrojtur fuqishëm ministri i Financave, i cili po ashtu është i PDK-së, dhe ai e ka mbrojtur qëndrimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

E kemi një situatë, ku është bërë një plagjiaturë, sepse ka dalë në opinion që një amendament, faktikisht e ka shndërruar në ligj është i filan filanit, deputetit të PDK-së, që është një e pavërtetë.

Atë nuk është hedhur në votim ligji, sepse ligji në fjalë të cilin e kanë udhëhequr deputetët e LDK-së, si kryetar i grupit punues dhe i komisionit do ta votonin në tërësi.

Xhavit Haliti i PDK-së nuk e ka qitë, e ka qitë vetëm amendamentin e deputetit Bekim i cili është thirrur gjoja se nuk ka kaluar ligji.

LDK-ja i mbështet të gjitha sponsorizimet që kanë të bëjnë me sport dhe iu uron shumë suksese sportistëve të cilët nuk janë të ndërlidhur me këtë ligj, sepse edhe ju zoti ministër...

KRYESUESI: Faleminderit! Memli Krasniqi, kundër replikë! Unë jam i detyruar që ta zbatoj Rregulloren.

MEMLI KRASNIQI: Zoti Osmani, ju s'jeni deputet për herë të parë që të mos thuhet se nuk i dini rregullat.

Atë ditë dhe jo vetëm atë ditë, po që tri herë në seancë kemi mbetur te një amendament, amendamenti 5, i cili shprehimisht e rrëzon atë amendament tëndin dhe të komisionit që e keni udhëhequr ju, i cili i cenon sponsorizimet në Kosovë.

Amendamenti që ju po thoni se e kishe votuar, është amendamenti kundër të cilit jemi ne. Është amendamenti i cili nuk lejon të sponsorizohen sporte në Kosovë. Amendamenti që kemi kërkuar të mbështetet, është amendamenti që i jep validitet legal edhe Ligjit të sponsorizimeve që t'ju mundësohen ato që po i kërkojnë sportistët e Kosovës.

Kështu që, atë ditë do duhej të votoj amendamenti, në mënyrë që të votohet ligji. Ju s'e keni votuar. Tre deputetë të LDK-së keni marrë pjesë në votim, përveç Ademit asnjë i Vetëvendosjes. Krejt këta deputetë që i kem këndeje në koalicion e kanë votuar. Ju jeni duke e pamundësuar kalimin e atij ligji. Kjo është e vërteta dhe çka do që të thoni tjetër, ju demantojnë votat që i keni dhënë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pjesa më e madhe e kësaj është plotësisht jashtë rendit të ditës. Duhet të vazhdojmë... Ju lutem për vëmendje!

Debati s'ka të bëjë me këtë pikë të rendit të ditës, dhe është i panevojshëm. Kosova ka ligj për sponsorizim. Është miratuar më 23 dhjetor të vitit 2016.

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Me gjithë tendencën ndoshta të një pjese të deputetëve për t'u defokusuar nga tema kryesore, dhe deri diku ndoshta ia arritën që temën kryesore ta zëvendësojnë me një temë që mund ta diskutojmë në seancë tjetër, atëherë unë po tentoj që të kthehem sërish në temë.

Po e kuptoj që edhe në temën për atë që s'është thirrur seanca, ndoshta dikujt i leverdisë që të fokusohet edhe në aspekte procedurale; se a ka pasur kuorum apo s'ka pasur kuorum, cilat kanë qenë procedurat e kështu me radhë.

Këto rregulla, unë nuk dua t'i përjashtoj tani, pra dua që t'i respektoj. Por, gjithsesi nuk dua që të shpërqendrohemi nga faktet kryesore që e kanë sjellë deri në këtë pikë pozicionin e Kosovës.

E çmoj, pra punën e komisionit dhe po ashtu me gjithë konsideratën për punën voluminoze të këtij komisioni, me gjithë intervistimet e shumta të faktorëve dhe aktorëve për përpilimin e këtij raporti në mënyrë shumë profesionale.

Me gjithë kohën që e ka harxhuar Komisioni Hetimor Parlamentar, një gjë është dashur ose është ditur shumë herët. Pra, nuk është dashur dhe nuk ka qenë e vështirë të kuptohet se kush është përgjegjësi kryesor për dëbimin klandestin të gjashtë shtetasve turq nga Kosova.

Përgjegjësi kryesor, autori dhe skenaristi i krejt kësaj për të cilën ne sot po flasim, mbetet presidenti i vendit.

Ju mund të thirrni aktorë e faktorë të tjerë, por strumbullari i gjithë kësaj ngjarjeje mbetet presidenti i vendit. Të tjerat të gjetura, mbase edhe e komplementojnë këtë fakt. Pra, thjesht ky është në pazar i tij, me urdhër nga një president i një shteti tjetër.

Veprimet e tij antikushtetuese dhe antiligjore e në këtë rast edhe antihumane e bënë Thaçin që të jetë shkelës serioz i Kushtetutës dhe i ligjeve të vendit e në rastin konkret edhe i sovranitetit të vendit.

Veprimet e tij në dëbimin e shtetasve turq, janë veprime antiligjore dhe në mospërputhje me mandatin e tij, që i bie që ai e ka shkelur mandatin e tij për të shumtën herë edhe në këtë rast.

Presidenti i vendit nuk ka mandat ekzekutiv që mund t'i urdhërojë organet e sigurisë e aq më tepër në mënyrë konspirative. Por, Thaçi ka konflikt interesi në këtë rast me dy shtete të veçanta; ka konflikt interesi edhe me Turqinë ashtu siç ka konflikt interesi edhe me Serbinë.

Në raport me Turqinë ai është peng i kontratave të dëmshme biznesore, kurse në raport me Serbinë është peng i akuzave dhe i Gjykatës Speciale. Prandaj, nuk do duhej që në krye të këtij vendi të na përfaqësonte një njëri që tashmë është peng dhe i shantazhuar.

Unë, do të doja që në krye të vendit ta kishim një president me të cilin edhe do të krenohesha ose së paku nuk do të ndihesha keq për nivelin e tij.

Jo që nuk mund të krenohemi me këtë president, por ky njëri prej se është në pushtet veç sa na ka turpëruar.

Na ka turpëruar edhe para armiqve deri te përkulja para pllakave ku shkruhet që shqiptarët janë terroristë e NATO-ja agresore. Na ka turpëruar dhe në takim me Vuçiqin e Putinin, por edhe në raport me miqtë, ky njeri kurrë nuk na ka bërë që të ndjehemi krenarë.

Niveli i tij mediokër, por dinak, i paditur, por mburravec, ka bërë që të na vjen turp se kush na përfaqëson.

Prandaj, në ditën e raportimit para Komisionit Hetimor, ky njeri e quajti një shtetas amerikan, ekspert të fushës, si spiun. Ndërsa, në zyrën e tij e mbante një spiun serb i quajtur Branislav Nikoliq.

Ai e shkarkoi këtë spiun serb nga zyra e tij, jo kur ai e kuptoi se ky është spiun i BIA-s, por kur opinionin e kuptoi një gjë të tillë.

Tekefundit çfarë problemesh kanë pushtet në Turqi, opozita dhe pozita. Çfarë problemesh kanë forcat politike atje, neve ndoshta edhe na intereson po ndoshta edhe nuk na intereson. Mirëpo, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm që problemet e Turqisë të mos i importojnë dhe t'i kthejmë si probleme të Kosovës, sepse shteti i Kosovës ka kohë që nuk është provincë e Perandorisë Osmane edhe pse në krye të këtij vendi është një president vasal i Erdoganit.

Aeroporti i Kosovës nuk është aeroport i Turqisë edhe pse këtë aeroport e menaxhon një kompani turke. Por, për kolegët e mi mazhoritar, kam një pyetje krejt konkretet: A ka qenë gabim apo nuk ka qenë gabim dëbimi i gjashtë shtetasve turq?

Na thoni këtu. Nëse nuk ka qenë gabim dhe ka qenë e drejtë, atëherë pozicioni juaj dihet, por nëse ka qenë gabim atëherë a nuk duhet që ne t'i kërkojmë përgjegjësit? Si ju po doni që të thoni se ka qenë gabim, por përgjegjësit nuk janë relevant në këtë rast.

Prandaj, me gjithë konsideratën për punën voluminoze të Komisionit Hetimor, nuk do nevojitej shumë mund që të kuptohet se kush është përgjegjësi në këtë rast.

Thaçi thjesht është në raport mes dy urdhrave; urdhrat që ka marrë dhe urdhrat që i ka dhënë. Ai ka marrë një urdhër nga një shtet tjetër dhe e ke zbatuar me besnikëri, që përbën një anë të gabimit, dhe ana tjetër e gabimit është se ai ka dhënë urdhra në disperputhje me mandatin e tij si president, e duke e ditur që presidenti nuk ka mandat ekzekutiv.

Prandaj, unë si shumë prej jush, refuzoj të udhëhiqem dhe të përfaqësohem nga një njëri i tillë. Prandaj, ky nuk është presidenti im.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, fjalën e ka deputeti Blerim Kuçi!

BLERIM KUÇI: Faleminderit, nënkryetar!

KRYESUESI: Blerim, një minutë më fal! Regjia, ju lutem një minutë! Glauku do të paraqesë një mocion. Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Po edhe prej nesh janë paraqitur edhe shumë të tjerë, ashtu siç mund të ketë edhe prej partive të tjera parlamentare, mirëpo unë do të kërkoja një mirëkuptim prej të gjitha grupeve parlamentare. Ashtu siç e shpjeguem qëndrimin ne dhe LDK-ja, ma merr mendja që edhe shumica e subjekteve këtu që funksionojnë në Parlamentin e Kosovës mund ta kenë një mirëkuptim të tillë.

Meqenëse, po vërehet njëfarëlloj pajtueshmërie e mendimeve të të gjithë deputetëve se kemi të bëjmë me një raport përgjithësisht profesional, pra i shkruar në mënyrë të mirë dhe që e shpjegon ngjarjen mirë dhe në mënyrë objektive, atëherë këtu po vërehet që i kemi edhe 18 folës edhe do të ishte mirë ndoshta që të shkohet drejt në votim. Këtu u ngritën prej vet Grupit Parlamentar të PDK-së, si propozim. Domethënë tash kemi qëndrimin faktikisht të LDK-së, të Vetëvendosjes dhe të PDK-së që do të mund të shkonim në votim drejtpërdrejt.

Atëherë, unë ju kisha lutur zoti nënkryetar që t'i merrni edhe mendimet e subjekteve të tjera parlamentare dhe nëse kemi një konsensus të përgjithshëm këtu në Parlament, pse të mos shkojmë drejtpërdrejt në votim dhe ta përfundojmë më shpejt këtë votimin e këtij raporti të rëndësishëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, sipas Rregullores në këtë rast, së pari duhen qëndrimet e shefave të grupeve parlamentare. Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Ne jemi dakord.

KRYESUESI: Faleminderit! Partia Demokratike e Kosovës, zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Po, edhe ne jemi dakord.

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Faktikisht, unë e thashë propozimin. Po.

KRYESUESI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Zoti nënkryetar, nëse vazhdon debati me fol përtej siç po ndodh, ne jemi që të ndërpritet debati dhe të shkohet në votim.

Për shembull, ndoshta Rexhep Selimi mund ta dijë se kush ka qenë urdhërdhënësi i dëbimit të gjashtë shtetasve turq. Është e mundur që të dyshojmë edhe ne se kush ka qenë, po duhet të thuhet nga anëtarët e komisionit, duke filluar nga kryetari, nga nënkryetari dhe të gjithë anëtarët tjerë.

KRYESEUSI: Muharrem, ju lutem vetëm për procedurë. Vetëm qëndrimin.

MUHARREM NITAJ: Edhe unë e kam për procedurë, ju lutem.

KRYESUESI: Qëndrimin, po ose jo?

MUHARREM NITAJ: Ju lutem, duhet të thuhet se Komisioni Hetimor nuk ka gjetur asnjë argument, asnjë dëshmi, asnjë deklaratë...

KRYESUESI: Ju po e vazhdoni debatin. Na duhet qëndrimi lidhur me mocionin.

MUHARREM NITAJ: Dëgjo! Nëse ju doni të bëni politikë, po bëjmë politikë. Nëse dëshironi ta votoni një raport po e votojmë raportin.

KRYESUESI: Qëndrimin, po ose jo?

MUHARREM NITAJ: Qëndrimi ishte i qartë, nëse vazhdohet me debate politike...

KRYESUESI: Jo, jo lidhur me mocionin.

MUHARREM NITAJ: Nëse doni t'i ndërprisni debatet dhe të votohet, Aleanca mund të votojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së. Kush e kërkon fjalën? Deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Në fakt, ne mendojmë se përveç...Ka arsye që të diskutohet edhe mbi të gjeturat e raportit, sepse deputetët mund të kenë edhe rekomandime tjera shtesë. Pra, ata që nuk kanë qenë pjesë e komisionit për të përfshirë ose në raport ose në një rezolutë apo çfarëdo tjetër që do ta nxirrte Kuvendi.

Prandaj, mendojmë se diskutimet duhet të vazhdojnë, përveç nëse ka deputetë që duan t'i përsërisin.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Nisma. Kryetari, zoti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesuese!

Në emër të Grupit Parlamentar të Nismës, refuzojmë që të ndërpritet debati. Besojmë që duhet të vazhdojë debati, në mënyrë që secili deputet që dëshiron të flasë për këtë çështje t'i jepet mundësia.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+. Kryetari, zoti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe ne si grup parlamentar, duke e pasur parasysh faktin se ka shumë deputetë të cilët janë të interesuar të debatojnë për këtë çështje, ne jemi të interesuar që debati të vazhdojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lus Administratën që ta konfirmojë praninë e deputetëve.

Atëherë, në sallë janë 69 deputetë. Për këtë mocion, seanca duhet të deklarohet me anë të procesit të votimit. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tani!

A ka ndonjë deputet që voton me dorë? Shoh ka që ka kolegë të cilët kërkojnë që të përsëritet votimi. A jeni dakord? Sa janë me dorë? Dy me dorë. 59 në mënyrë elektronike dhe 2 me dorë, 61. Domethënë i bie që janë 52 për, 4 kundër dhe 1 abstenim. Mocioni është miratuar.

Në bazë të këtij rezultati, atëherë ne kalojmë drejtpërdrejt në proces të votimit të raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar. Lus deputetët që të kthehen në sallë. Pra, brenda pak sekondash do të bisedojmë. Fjalën nuk ia jep askujt, sepse seanca vendosi që të mos e vazhdojmë debatin. Sa deputetë janë në sallë? 68. Atëherë, domethënë kemi kuorum.

Unë lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tani. A ka deputetë të cilët votojmë me dorë? 2, 3. Po kërkonin që të përsëritet? Në rregull! Duket që ka probleme, kështu që e përsërisim edhe njëherë procesin e votimit. Nëse do të keni probleme... Ata kolegë që do të kenë probleme, do të deklarohen me dorë. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tani.

Faleminderit! Procesi i votimit u mbyll. Në mënyrë elektronike kanë votuar 64 deputetë. 1 me dorë, 65. 59 deputetë janë për, 2 kundër, 4 abstenime. Kuvendi e miratoi raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars.

Me këtë i mbyllim punimet e kësaj seance. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*